FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 195

Tiranë – E mërkurë, 11 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 253, datë 23.10.2020	Për shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare".....	13509
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 261, datë 27.10.2020	Për shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 4 "Instrumentet financiare" (SNRF 4) dhe të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 17 "Kontratat e sigurimit" (SNRF 17).....	13509
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 615, datë 9.11.2020	Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve.....	13546
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 616, datë 9.11.2020	Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit.....	13546
Autorizim i ministrit të Brendshëm nr. 7949, datë 3.11.2020	Për nënshkrim marrëveshjeje.....	13547
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 99, datë 16.10.2020	Autorizim i ndihmës shtetërore "Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbërta', të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese, të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbërta', duke futur elemente *go-green* në to".....	13547
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 4, datë 23.10.2020	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror".....	13549
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 163, datë 22.10.2020	Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.....	13550

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 22.10.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror".....	13553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 22.10.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të matjes së gazit natyror".....	13554
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 22.10.2020	Mbi miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit".....	13555
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 167, datë 22.10.2020	Mbi zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	13563
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 109, datë 18.9.2020	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mirditë sh.a.....	13564
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 119, datë 20.10.2020	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Peqin sh.a.....	13565
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 120, datë 20.10.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a".....	13570
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 122, datë 20.10.2020	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a.....	13571
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13070, datë 4.11.2020	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	13572
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4759/2, datë 4.11.2020	Për shpronësimin, marrjen në përdorim të përkohshëm, për 6 (gjashtë) muaj, 1 (një) vit, 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, 2 (dy) vjet dhe 2 vjet e 6 (gjashtë) muaj, si dhe vendosjen e servitutit mbi pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga punimet "Për testimin me ujë të tubacionit, si dhe përfundimi i punimeve, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP), në zonat Berat, Skrapar, Fier, Devoll dhe Korçë".....	13572
	Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Armelinda Mark Baraku.....	13582
	Kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të shpalljes së vdekur të shtetasit Kristjan Gjergj Nika.....	13582

URDHËR
Nr. 253, datë 23.10.2020

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 1 "PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE"

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit",

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" (SNK 1).
2. Ndryshimet e SNK 1, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 janar 2023. Lejohet zbatimi përpara datës efektive, por njësia ekonomike duhet të japë shënime shpjeguese për këtë fakt.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Ndryshime në SNK 1 *"Paraqitja e pasqyrave financiare"*

Paragrafi 139U ka ndryshuar. Teksti i fshirë është bërë me vizë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

139U *Klasifikimi i detyrimeve, si afatshkurtër ose afatgjatë*, i publikuar në janar 2020, ndryshoi paragrafët 69, 73, 74 dhe 76, si dhe shtoi paragrafët 72A, 75A, 76A dhe 76B. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar ~~2022~~2023 ose pas kësaj date, në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

URDHËR
Nr. 261, datë 27.10.2020

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 4 "INSTRUMENTET FINANCIARE" (SNRF 4) DHE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 17 "KONTRATAT E SIGURIMIT" (SNRF 17)

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit",

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 4 "Instrumentet financiare" (SNRF 4) dhe të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 17 "Kontratat e sigurimit" (SNRF 17).
2. Ndryshimet e SNRF 4 dhe të SNRF 17, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 janar 2023.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Zgjatje e Përjashtimit të Përkohshëm në Zbatimin e SNRF 9

Ndryshime të SNRF 4

Ndryshime të SNRF 4 *Instrumentet Financiare*

Janë ndryshuar paragrafët 20A, 20J dhe 20O. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Përjashtime të përkohshme nga SNRF 9

20A **SNRF 9 trajton kontabilitetin për instrumentet financiare dhe zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2018 ose më pas. Megjithatë, për një sigurues që plotëson kriteret në paragrafin 20B, ky SNRF jep një përjashtim të përkohshëm që lejon, por nuk kërkon, që siguruesi të zbatojë SNK 39 *Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja* dhe jo SNRF 9, për periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2023~~2021~~. Një sigurues që do të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 duhet të:**

(a) ...

...

20J Nëse një njësi ekonomike si rezultat i rivlerësimit nuk kualifikohet për më tej për një përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 (shih paragrafin 20G(a)), atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri në fund të periudhës vjetore raportuese që fillon menjëherë pas këtij rivlerësimi. Por, njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2023~~2021~~ e në vijim. Për shembull, nëse një njësi ekonomike duke aplikuar paragrafin 20G(a) më 31 dhjetor 2018(fundi i periudhës së saj vjetore), përcakton se ajo nuk kualifikohet më për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të zbatojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri më 31 dhjetor 2019.

...

Përjashtim i përkohshëm nga kërkesat e veçanta të SNK 28

20O Paragrafët 35–36 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta* kërkojnë që njësia ekonomike të zbatojë politika kontabël uniforme kur përdor metodën e kapitalit neto. Megjithatë, për periudhat vjetore që fillojnë para datës 1 janar 2023~~2021~~, njësisë ekonomike i lejohet, por nuk i kërkohet, të mbajë të njëjtat politika përkatëse kontabël të zbatuara nga pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta si më poshtë:

(a) ...

...

Ndryshime të SNRF 17

Ndryshime të SNRF 17 *Kontratat e Sigurimit*

Paragrafët 4 dhe 7 janë ndryshuar dhe paragrafi 8A është shtuar. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qëllimi

...

4 Të gjitha referencat në SNRF 17 për kontratat e sigurimit zbatohen edhe për:

(a) kontratat e risigurimit të mbajtura, me përjashtim të:

(i) ...

(ii) siç përshkruhet në paragrafët 60–70A~~70.~~

(b) ...

...

7 Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë SNRF 17 për:

...

(h) kontratat e kartave të kreditit ose për kontrata të ngjashme të cilat ofrojnë marrëveshje kreditimi ose pagese, që plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi nëse dhe vetëm nëse njësia ekonomike kur vendos çmimin e kontratës për atë klient nuk pasqyron një vlerësim të rrezikut të sigurimit të lidhur me klientin individual (shih SNRF 9 dhe SNRF-të e tjera të zbatueshme). Megjithatë nëse dhe vetëm nëse SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike të veçojë përbërësin mbulim sigurimi (shih paragrafin 2.1(e)(iv) të SNRF 9) të përfshirë tashmë në një kontratë të tillë, njësia duhet të zbatojë SNRF 17 ndaj atij përbërësi.

...

8A Disa kontrata plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi por kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në shumën që do të kërkohej sipas rastit për të shlyer detyrimin e policëmbajtësit të krijuar nga kontrata (për shembull, huatë me heqje dore në rast vdekje). Njësia ekonomike duhet të zgjedhë të zbatojë SNRF 17 ose SNRF 9 ndaj kontratave të tilla të cilat i emeton me përjashtim të rastit kur këto kontrata përjashtohen nga objekti i SNRF 17 nga paragrafi 7. Njësia ekonomike duhet të bëjë këtë zgjedhje për secilin *portofol kontratash sigurimi*, si dhe zgjedhja për secilin portofol është e pakthyeshme.

Janë ndryshuar paragrafët 10–12. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Ndarja e përbërësve nga një kontratë sigurimi (paragrafët B31–B35)

10 Një kontratë sigurimi mund të përmbajë një ose më shumë përbërës të cilët mund të jenë brenda objektit të ndonjë Standardi tjetër nëse ato do të ishin kontrata të veçanta. Për shembull, një kontratë sigurimi mund të përfshijë një *përbërës investimi* ose një ~~përbërës shërbimi~~ përbërës për shërbime të ndryshme nga *kontrata sigurim shërbimesh* (ose të dy). Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 11–13 për të identifikuar dhe për të trajtuar përbërësit e kontratës.

11 Njësia ekonomike do:

(a) ...

(b) të veçojë nga kontrata e sigurimit mëmë (mbajtëse) një përbërës investimi nëse dhe vetëm nëse ai përbërës investimi është i dallueshëm (shih paragrafët B31–B32). Njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për trajtimin e përbërësit të veçuar të investimit përveç nëse është një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17 (shih paragrafin 3(c)).

12 Pas zbatimit të paragrafit 11 për të veçuar flukset e mjeteve monetare të lidhura me derivativët e përfshirë dhe përbërësit e investimit të dallueshëm, njësia ekonomike do të veçojë nga kontrata e sigurimit mëmë çdo premtim për të transferuar tek një policë mbajtës mallra të dallueshëm ose ~~shërbime jo të siguruara~~

shërbime të ndryshme nga kontrata sigurim shërbimesh~~tek një policë mbajtës~~, duke zbatuar paragrafin 7 të SNRF 15. Njësia ekonomike do të trajtojë premtime të tilla duke zbatuar SNRF 15. Gjatë zbatimit të paragrafit 7 të SNRF 15 për të veçuar premtimin, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët B33–B35 e SNRF 17 dhe në njohjen fillestare do të:

(a) zbatojë SNRF 15 për të përcaktuar hyrjet e mjeteve monetare mes përbërësit sigurues dhe çdo premtimi për të ofruar mallra të dallueshme ose~~ shërbime jo sigurimi~~ shërbime të dallueshme të ndryshme nga kontrata për sigurim shërbimesh; dhe

(b) përcaktojë daljet e mjeteve monetare mes përbërësit sigurues dhe çdo malli ose~~ shërbimi jo sigurimi~~ shërbimi të premtuar të ndryshëm nga kontrata për sigurim shërbimesh, të trajtuar duke zbatuar SNRF 15 në mënyrë të tillë që:

...

...

Janë ndryshuar paragrafët 19 dhe 24. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është paraqitur me vijë në mes.

Niveli i bashkimit në kontratat e sigurimit

...

19 Për kontratat e emetuara dhe për të cilat njësia ekonomike nuk zbaton metodën e shpërndarjes së primit (shih paragrafët 53–54~~59~~), njësia ekonomike do të vlerësojë nëse kontratat të cilat nuk janë me kushte rënduese në njohjen fillestare nuk kanë shumë mundësi të bëhen të tilla:

...

24 Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për njohjen dhe matjen të SNRF 17, për grupet e kontratave~~ të emetuara~~ të përcaktuara duke zbatuar paragrafët 14–23. Njësia ekonomike duhet të krijojë grupet në njohjen fillestare dhe të shtojë kontrata në grupe duke zbatuar paragrafin 28.~~ dhe~~ Njësia ekonomike nuk do të rivlerësojë më pas përbërjen e grupeve. Për të matur një grup kontratash, njësia ekonomike mund të vlerësojë flukset e realizuara të mjeteve monetare në një nivel më të lartë të bashkimit se grupi apo portofoli, me kushtin që njësia ekonomike të jetë në gjendje të përfshijë flukset e duhura të realizuara të mjeteve monetare duke zbatuar paragrafët 32(a), 40(a)(i) dhe 40(b), duke i shpërndarë këto vlerësime tek grupet e kontratave.

Paragrafi 27 është fshirë dhe është shtuar paragrafi 28. Janë shtuar paragrafët 28A–28F si dhe një titull mbi paragrafin 28A. Paragrafi 25 nuk është ndryshuar por është përfshirë për lehtësi referimi. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Njohja

25 Njësia ekonomike do të njohë një grup të kontratave të sigurimit që ajo emeton nga periudha më e hershme e sa vijon:

(a) e fillimit të *periudhës së mbulimit* të grupit të kontratave;

(b) e datës kur pagesa e parë nga një policë mbajtës në grup bëhet e detyrueshme; dhe

(c) për një grup kontratash detyruese, kur grupi bëhet me kushte rënduese.

...

27 [Fshirë]~~Njësia ekonomike do të njohë një aktiv ose një detyrim për çdo *fluks monetare të blerjes së sigurimit* që vjen nga një grup i kontratave të sigurimit të emetuara, të cilat njësia ekonomike i paguan ose i merr para se grupi të njihet, pavarësisht nëse zgjedh t'i njohë ato si shpenzime apo të ardhura duke zbatuar paragrafin 59(a). Një njësi ekonomike nuk do të njohë aktivin ose detyrimin që vjen nga të tilla flukse monetare të blerjes së sigurimit nëse njihet grupi i kontratave të sigurimit të cilave u përkasin këto flukse monetare (shih paragrafin 38(b)).~~

28 Gjatë njohjes së një grupi kontratash sigurimi në periudhën e raportimit, njësia ekonomike do të përfshijë vetëm kontratat që plotësojnë individualisht një nga kriteret e paraqitura në paragrafin 25~~e emetuara në fund të periudhës së raportimit~~ dhe duhet të vlerësojë normat e skontimit në datën e njohjes fillestare (shih

paragrafin B73) dhe njësitë e mbulimit të siguruara në periudhën e raportimit (shih paragrafin B119). Njësia ekonomike mund të përfshijë~~të emetojë~~ më shumë kontrata në grup pas fundit të periudhës së raportimit, objekt i paragrafëve 14–22~~paragrafit 22~~. Njësia ekonomike mund të shtojë një kontratë~~kontratat~~ në grup në periudhën e raportimit në të cilën kontrata plotëson një nga kriteret e paraqitura në paragrafin 25~~kontratat janë emetuar~~. Kjo mund të sjellë një ndryshim në përcaktimin e normave të skontimit në datën e njohjes fillestare gjatë zbatimit të paragrafit B73. Njësia ekonomike do të zbatojë normat e rishikuara nga data e fillimit të periudhës së raportimit në të cilën~~kontratat~~ kontratat e reja janë shtuar në grup.

Flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafët B35A–B35D)

28A Njësia ekonomike duhet të shpërndajë *flukset monetare të blerjes së sigurimit* tek grupet e kontratave të sigurimit duke përdorur një metodë sistematike dhe racionale në zbatim të paragrafëve B35A–B35B, me përjashtim të rastit kur ajo zgjedh t'i njohë ato si shpenzime në zbatim të paragrafit 59(a).

28B Një njësi ekonomike që nuk zbaton paragrafin 59(a) duhet të njohë flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara si një aktiv (ose flukset monetare të blerjes së sigurimit për të cilin është njohur një detyrim në zbatim të një SNRF tjetër) para se të njihet grupi përkatës i kontratave të sigurimit. Njësia ekonomike duhet të njohë një aktiv të tillë për secilin nga grupet përkatëse të kontratave të sigurimit.

28C Njësia ekonomike duhet të çregjistrojë aktivin për flukset monetare të blerjes së sigurimit nëse këto flukse janë përfshirë në matjen e grupit përkatës të kontratave të sigurimit në zbatim të paragrafit 38(c)(i) ose paragrafit 55(a)(iii).

28D Nëse zbatohet paragrafi 28, njësia ekonomike duhet të zbatojë paragrafët 28B–28C në përputhje me paragrafët B35C.

28E Në fund të çdo periudhe raportimi, njësia ekonomike duhet të vlerësojë rikuperimin e një aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se aktivi mund të jetë zhvlerësuar (shih paragrafin B35D). Nëse njësia ekonomike identifikon një humbje nga zhvlerësimi, ajo duhet të rregullojë vlerën kontabël (neto) të aktivit dhe të njohë në rezultatin e periudhës humbjen nga zhvlerësimi.

28F Njësia ekonomike do të njohë në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës) anullimin e një pjese ose të të gjithë humbjes nga zhvlerësimi të njohur më parë në përputhje me paragrafin 28E dhe një rritje në vlerën kontabël (neto) të aktivit në masën që kushtet për zhvlerësim nuk ekzistojnë më ose janë përmirësuar.

Janë ndryshuar paragrafi 29 dhe titulli sipër tij. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Matja (paragrafët B36–B119F~~B119~~)

29 Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 30–52 tek të gjitha grupet e kontratave të sigurimit që janë brenda objektit të SNRF 17, me përjashtimet në vijim:

(a) …

(b) për grupet e kontratave të risigurimit të mbajtura, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 32–46 siç kërkohet në paragrafët 63–70A~~70~~. Paragrafi~~Paragrafët~~ 45 (për *kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë*) dhe paragrafët 47–52 (për kontratat me kushte rënduese) nuk zbatohen për grupet e kontratave të risigurimit të mbajtura.

…

Është ndryshuar titulli për paragrafin 32. Janë ndryshuar paragrafët 34 dhe 38–39. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Matja në njohjen fillestare (paragrafët B36–B95F~~B95~~)

...

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare (paragrafët B36–B71)

...

34 Flukset e mjeteve monetare janë brenda kufijve të një kontrate sigurimi nëse ato vijnë nga të drejta dhe detyrime thelbësore të cilat ekzistojnë gjatë periudhës së raportimit, në të cilën njësia ekonomike mund të detyrojë policë mbajtësin të paguajë primet ose në të cilën njësia ekonomike ka një detyrim themelor për t'i ofruar policë mbajtësit kontratë sigurim shërbimesh (shih paragrafët B61–B71). Një detyrim thelbësor për të ofruar kontratë sigurim shërbimesh përfundon kur:

(a) ...

(b) plotësohen të dyja kushtet vijuese:

(i) ...

(ii) vendosja e çmimit për primet ~~e mbulimit~~ deri në datën kur rreziqet rivlerësohen nuk merr në konsideratë rreziqet që lidhen me periudhat pas datës së rivlerësimit.

...

Marzhi i kontraktuar i shërbimit

38 Marzhi i kontraktuar i shërbimit është një përbërës i aktivit ose detyrimit për grupin e kontratave të sigurimit dhe paraqet fitimin e parealizuar që njësia ekonomike do të njohë në të ardhmen kur të kryejë shërbimet e kontratës së sigurimit. Njësia ekonomike do të masë marzhin e kontraktuar të shërbimit në njohjen fillestare të një grupi kontratash sigurimi me një shumë e cila, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 47 (për kontratat me kushte rënduese) ose paragrafi B123A (mbi të ardhurat e sigurimit të lidhura me paragrafin 38(c)(ii), nuk sjell të ardhura apo shpenzime që vijnë nga:

(a) ...

(b) çdo fluksi të mjeteve monetare të ardhur nga kontratat në grup në atë datë;

(c)~~(b)~~ mosnjohje (çregjistrim) në datën e njohjes fillestare të:

(i) çdo aktivi ~~ose detyrimi të njohur~~ për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C~~27~~; dhe

(ii) çdo aktivi ose detyrimi tjetër të njohur më parë në flukset monetare të grupit të kontratave siç specifikohet në paragrafin B66A.

~~(c) çdo fluksi monetar të ardhur nga kontratat në grup në atë datë.~~

39 Për kontratat e sigurimit të blera në një transferim kontratash sigurimi ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e paragrafit 38 në përputhje me paragrafët B93–B95F~~B95~~.

Janë ndryshuar paragrafët 44–45 dhe titulli sipër tyre. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Marzhi i shërbimit kontraktual (paragrafët B96–B119B~~B119~~)

...

44 Për *kontratat e shërbimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë*, vlera kontabël (neto) e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash, në fund të periudhës raportuese është sa vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese e korrigjuar me:

...

(e) shumën e njohur si e ardhur nga sigurimi për shkak të transferimit të shërbimeve të kontratës së sigurimit gjatë periudhës, e përcaktuar nga shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës së raportimit (para çdo shpërndarjeje) gjatë periudhës aktuale dhe të mbetur të mbulimit, duke zbatuar paragrafin B119.

45 Për kontratat e sigurimit me një tipar të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (shih paragrafët B101–B118), vlera kontabël (neto) e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash, në fund të periudhës raportuese është sa vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese e korrigjuar për shumat e cilësuara në nënparagrafët (a)–(e) më poshtë. Njësisë ekonomike nuk i kërkohet që të identifikojë veçmas këto korrigjime. Por një shumë e vetme mund të përcaktohet për disa apo për të gjitha korrigjimet. Korrigjimet janë:

(a) …

(b) ndryshimi në shumën e pjesës së njësisë ekonomike ~~ndryshimin në~~ vlerën e drejtë të *zërave bazë (të nënkuptuar)* (shih paragrafin B104(b)(i)), me përjashtim të madhësisë për të cilën:

(i) …

(ii) pakësimi në shumën e pjesës së njësisë ekonomike ~~një pakësim të~~ vlerën e drejtë të zërave bazë, tejkalon vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit, duke sjellë si pasojë një humbje (shih paragrafin 48); ose

(iii) rritja në shumën e pjesës së njësisë ekonomike ~~një rritje në~~ vlerën e drejtë të zërave bazë, anulon shumën në pikën (ii).

…

(e) shuma e njohur si e ardhur nga sigurimi për shkak të transferimit të shërbimeve të kontratës së sigurimit gjatë periudhës, e përcaktuar nga shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës së raportimit (para çdo shpërndarjeje) gjatë periudhës aktuale dhe të mbetur të mbulimit~~,~~ duke zbatuar paragrafin B119.

…

Janë ndryshuar paragrafët 47–48 dhe 50. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Kontratat me kushte rënduese

47 Një kontratë sigurimi është me kushte rënduese në datën e njohjes fillestare nëse flukset monetare të realizuara që i takojnë kontratës, ndonjë fluks monetar i blerjes së sigurimit i njohur më parë dhe ndonjë fluks monetar që vjen nga kontrata në datën e njohjes fillestare në total janë flukse dalëse neto. Në zbatim të paragrafit 16(a), njësia ekonomike do të grupojë kontrata të tilla veçmas nga kontratat që nuk janë me kushte rënduese. Deri në masën që zbatohet paragrafi 17, njësia ekonomike mund të identifikojë grupin e kontratave me kushte rënduese duke matur një grup kontratash në vend të matjes së kontratave individuale. Njësia ekonomike do të njohë një humbje në fitim ose humbje për fluksin neto dalës të grupit të kontratave me kushte detyruese, për të cilat rezulton se vlera kontabël (neto) e detyrimit për grupin, të jetë sa flukset monetare të realizuara dhe marzhi i shërbimit i kontraktuar për grupin të jetë zero.

48 Një grup kontratash sigurimi bëhet me kushte rënduese (ose më detyruese) në matjen e mëpasshme, nëse shumat në vijim tejkalojnë vlerën kontabël (neto) të marzhit të shërbimit të kontraktuar:

(a) për ndryshime jo të favorshme në flukset monetare të realizuara të shpërndara tek grupi lidhur me shërbimin e ardhshëm, që vijnë nga ndryshimet në flukset monetare të ardhshme dhe rregullimi i rrezikut për rrezikun jo-financiar~~të lidhur me shërbimin e ardhshëm~~; dhe

(b) për një grup kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, pakësimi në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike në ~~pakësimin e~~ vlerën e drejtë të zërave bazë.

Duke zbatuar paragrafët 44(c)(i), 45(b)(ii) dhe 45(c)(ii), njësia ekonomike do të njohë një humbje në rezultat në masën e atij tejkalimi.

…

50 Pasi njësia ekonomike ka njohur një humbje nga një grup i kontratave të sigurimit me kushte rënduese, ajo do të shpërndajë:

(a) …

(b) vetëm tek përbërësi humbje derisa ai përbërës të pakësohet në zero:

(i) çdo pakësim të mëpasshëm në flukset monetare të realizuara të shpërndara tek grupi lidhur me shërbimin e ardhshëm, që vjen nga ndryshimet në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme dhe rregullimi i rrezikut për rrezikun jo-financiar;~~të lidhur me shërbimin e ardhshëm~~ dhe

(ii) çdo rritje të mëpasshme në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike tënë vlerës së drejtë të zërave bazë ~~vetëm tek përbërësi humbje-derisa ai përbërës të paksëohet në zero~~.

Duke zbatuar paragrafët 44(c)(ii), 45(b)(iii) dhe 45(c)(iii), njësia ekonomike do të korrigjojë marzhin e kontraktuar të shërbimit vetëm për tejkalimin e rënies ndaj shumës së shpërndarë tek përbërësi humbje.

...

Janë ndryshuar paragrafët 53 dhe 55-56. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Metoda e shpërndarjes së primit

53 Njësia ekonomike mund të thjeshtojë matjen e një grupi kontratash sigurimi duke përdorur metodën e shpërndarjes së primit të paraqitur në paragrafët 55–59 nëse dhe vetëm nëse kur krijohet grupi:

(a) ...

(b) periudha e mbulimit e secilës kontratë në grup (përfshirë kontratën e sigurimit për shërbimin~~mbulimin~~ që vjen nga të gjitha primet brenda kufijve të kontratës të përcaktuar në datën e zbatimit të paragrafit 34) është një vit ose më pak.

...

55 Kur përdor metodën e shpërndarjes së primit, njësia ekonomike do ta masë detyrimin për mbulimin e mbetur si vijon:

(a) në njohjen fillestare, vlera kontabël (neto) e detyrimit është:

...

(iii) plus ose minus çdo shumë që vjen nga mosnjohja (çregjistrimi) në atë datë të:

1. çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C; dhe~~çdo aktivi ose detyrimi të njohur për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 27.~~

2. çdo aktivi ose detyrimi tjetër të njohur më parë në flukset monetare të grupit të kontratave siç specifikohet në paragrafin B66A.

(b) në fund të çdo periudhe pasuese raportimi, vlera kontabël (neto) e detyrimit është vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës së raportimit:

...

(v) minus shumën e njohur si të ardhur nga sigurimi për shërbimet~~mbulimin~~ e dhëna në atë periudhë (shih paragrafin B126); dhe

(vi) ...

56 Nëse kontratat e sigurimit në një grup kanë një përbërës të rëndësishëm financiar, njësia ekonomike do të rregullojë vlerën kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur për të reflektuar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar duke përdorur normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 36, siç kërkohet në njohjen fillestare. Nëse njësia ekonomike në datën e njohjes fillestare pret që koha ndërmjet datës së ofrimit të secilës pjesë të shërbimit~~mbulimit~~ dhe datës së primit korrespondues të jetë jo më shumë se një vit, ajo nuk ka nevojë që të rregullojë vlerën kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur për të reflektuar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar.

...

Janë ndryshuar paragrafët 60, 62, 65–66 dhe 69, paragrafi 62 është ndarë (degëzuar) duke krijuar një paragraf të ri 62A, paragrafi 65 është ndarë (degëzuar) duke krijuar një paragraf të ri 65A, janë shtuar paragrafët 66A–66B dhe 70A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Kontratat e risigurimit të mbajtura

60 Kërkesat në SNRF 17 modifikohen për kontratat e risigurimit të mbajtura, siç paraqiten në paragrafët 61–70A~~70~~.

...

Njohja

62 Në vend të zbatimit të paragrafit 25, njësia ekonomike do të njohë një grup kontratash risigurimi të mbajtura nga më herët se sa:

(a) fillimi i periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura; dhe

(b) data që njësia ekonomike njeh një grup të kontratave të sigurimit bazë me kushte rënduese duke zbatuar paragrafin 25(c), nëse njësia ekonomike ka hyrë në kontratën përkatëse të risigurimit të mbajtur në grupin e kontratave të risigurimit të mbajtuar në atë datë ose më parë.

62A Pavarësisht paragrafit 62(a), njësia ekonomike do ta vonojë njohjen e një grupi kontratash risigurimi të mbajtuara, që sjellin mbulim proporcional deri në datën që çdo kontratë bazë risigurimi është fillimisht njohur, nëse ajo datë është më vonë se fillimi i periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura.

~~62 Në vend të zbatimit të paragrafit 25, njësia ekonomike do të njohë një grup kontratash risigurimi të mbajtura:~~

~~(a) nëse kontratat e risigurimit të mbajtura ofrojnë mbulim proporcional – në fillim të periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura ose në njohjen fillestare të secilës prej kontratave të përfshira, cilado që është e mëvonshmja; dhe~~

~~(b) në të gjitha rastet e tjera – nga fillimi i periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura.~~

Matja

...

65 Kërkesat e paragrafit 38, që lidhen me përcaktimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit në njohjen fillestare, modifikohen për të pasqyruar faktin se për një grup të kontratave të risigurimit të mbajtura nuk ka fitim të pa përfituar, por në fakt një kosto ose fitim neto nga blerja e risigurimit. Kështu, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 65A, në njohjen fillestare~~: (a)~~ njësia ekonomike do të njohë çdo kosto ose fitim neto nga blerja e grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura si një marzh të kontraktuar shërbimi të matura me një shumë të barabartë me shumën e:

(a) flukseve monetare të realizuara;~~,~~

(b) shumën e çregjistruar në atë datë të ndonjë aktivi ose detyrimi të njohur më parë për flukset monetare të lidhura me grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura;~~dhe~~

(c) çdo fluks monetar që vjen në atë datë; dhe

(d) çdo të ardhur të njohur në fitim ose humbje duke zbatuar paragrafin 66A.~~; me përjashtim të rastit kur~~

65A Nëse ~~(b)~~kostoja neto e blerjes së mbulimit të risigurimit lidhet me ngjarje të cilat kanë ndodhur para blerjes së grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura, ~~në këtë rast,~~ pavarësisht kërkesave të paragrafit B5, njësia ekonomike do të njohë kosto të tilla menjëherë si shpenzime në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje).

66 Në vend të zbatimit të paragrafit 44, njësia ekonomike do ta masë marzhin e kontraktuar të shërbimit në fund të periudhës raportuese për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura me vlerën kontabël (neto) të përcaktuar në fillim të periudhës raportuese e të rregulluar për:

...

(ba) të ardhurën e njohur në fitimin ose humbjen e periudhës raportuese duke zbatuar paragrafin 66A;

(bb) anulimin e një përbërësi rikuperim humbjeje të njohur duke zbatuar paragrafin 66B (shih paragrafin B119F) në masën që këto anulime nuk ndryshojnë flukset monetare të realizuara të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura;

(c) ndryshimet në flukset monetare të realizuara, të matura me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(c), në masën që ndryshimi lidhet me shërbimin e ardhshëm, me përjashtim të rastit kur:

~~(i) lidhen me shërbimin e ardhshëm; me përjashtim të rastit kur~~

(i)~~(ii)~~ ndryshimi vjen nga një ndryshim në flukset e mjeteve monetare të realizuara, të shpërndara tek një grup kontratash sigurimi të përfshira, të cilat nuk rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit për grupin e kontratave të sigurimit të përfshira; ose~~.~~

(ii) ndryshimi vjen nga zbatimi i paragrafëve 57–58 (mbi kontratat me kushte rënduese), nëse njësia ekonomike mat një grup të kontratave të sigurimit të përfshira duke zbatuar metodën e shpërndarjes së primit.

...

66A Njësia ekonomike do të rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash risigurimi të mbajtura dhe si pasojë të njohë të ardhurën, kur njësia ekonomike njeh një një humbje në njohjen fillestare të një grupi me kushte rënduese të kontratave të risigurimit të përfshira ose në shtimin në një grup të kontratave të risigurimit të përfshira e me kushte rënduese (shih paragrafët B119C–B119E).

66B Njësia ekonomike duhet të krijojë (ose rregullojë) një përbërës rikuperimi humbjeje të aktivit për mbulimin e mbetur të një grupi kontratash risigurimi të mbajtura që përshkruajnë rikuperimin e humbjeve të njohura duke zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe 66A. Përbërësi rikuperim humbjeje përcakton shumat që paraqiten në fitim ose humbje si anulime të rikuperimeve të humbjeve nga kontratat e risigurimit të mbajtura dhe janë për pasojë të përjashtuara nga shpërndarja e primeve të paguara tek risiguruesi (shih paragrafin B119F).

...

Metoda e shpërndarjes së primit për kontratat e risigurimit të mbajtura

69 Njësia ekonomike mund të përdorë metodën e shpërndarjes së primit të paraqitur në paragrafët 55–56 dhe 59 (të përshtatur për të pasqyruar tiparet e kontratave të risigurimit të mbajtura, të cilat ndryshojnë nga kontratat e sigurimit të emetuara, për shembull gjenerimi i shpenzimeve ose pakësimi i shpenzimeve kundrejt të ardhurave) për të thjeshtuar matjen e një grupi kontratash risigurimi të mbajtura, nëse në datën e krijimit të grupit:

(a) ...

(b) periudha e mbulimit e secilës kontratë në grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura (përfshirë mbulimin e sigurimit, që vjen nga të gjitha primet brenda kufijve të kontratës të përcaktuar në atë datë duke zbatuar paragrafin 34) është një vit ose më pak.

...

70A Nëse njësia ekonomike mat një grup kontratash risigurimi të mbajtura duke zbatuar metodën e shpërndarjes së primit, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 66A duke rregulluar vlerën kontabël (neto) të aktivit për mbulimin e mbetur në vend të rregullimit të marzhit të kontraktuar të shërbimit.

Është ndryshuar paragrafi 71. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë

71 Një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë nuk përfshin transferim të një rreziku të rëndësishëm sigurimi. Për pasojë, kërkesat në SNRF 17 për kontratat e sigurimit modifikohen për kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë si vijon:

(a) data e njohjes fillestare (shih paragrafët 25 dhe 28~~paragrafi 25~~) është data kur njësia ekonomike bëhet palë në kontratë.

...

Janë ndryshuar paragrafët 72 dhe 76. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është paraqitur me vijë në mes.

Modifikimi dhe çregjistrimi

Modifikimi i një kontrate sigurimi

72 Nëse modifikohen kushtet e një kontrate sigurimi, për shembull sipas një marrëveshjeje mes palëve në kontratë ose për shkak të një ndryshimi në kërkesat ligjore, njësia ekonomike do të çregjistrojë kontratën fillestare dhe do të njohë kontratën e modifikuar si një kontratë të re, duke zbatuar SNRF 17 ose një Standard tjetër të zbatueshëm nëse dhe vetëm nëse plotësohet ndonjë nga kushtet në pikat (a)–(c). Ushtrimi i një të drejte të përfshirë në kushtet e kontratës nuk është modifikim. Kushtet janë:

(a) nëse kushtet e modifikuara janë përfshirë në krijimin e kontratës:

(i) kontrata e modifikuar do të përjashtohej nga objekti i SNRF 17, në zbatim të paragrafëve 3–8A~~8~~;

(ii) ...

...

Çregjistrimi

...

76 Njësia ekonomike çregjistron një kontratë sigurimi nga një grup kontratash duke zbatuar kërkesat në vijim të SNRF 17:

...

(c) numri i njësive të mbuluara nga kontratat e sigurimit të shërbimit~~mbulimin~~ të pritshme të mbetura, rregullohet për të reflektuar njësitë e mbuluara të çregjistruara nga grupi dhe shuma e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në rezultatin e periudhës bazohet në atë numër të rregulluar~~,~~ në zbatim të paragrafit B119.

...

Janë ndryshuar paragrafët 78–79. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar

78 Njësia ekonomike do të paraqesë veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar vlerën kontabël (neto) të portofolevegrupeve të:

(a) kontratave të sigurimit të emetuara që janë aktive;

(b) kontratave të sigurimit të emetuara që janë detyrime;

(c) kontratave të risigurimit të mbajtura që janë aktive; dhe

(d) kontratave të risigurimit të mbajtura që janë detyrime.

79 Njësia ekonomike do të përfshijë çdo aktiv apo detyrim nga flukset monetare të sigurimit të blerë të njohur duke zbatuar paragrafin 28B~~27~~ në vlerën kontabël (neto) të portofolevegrupeve përkatëse të kontratave të sigurimit të emetuara dhe çdo aktiv apo detyrim nga flukset monetare të lidhura me portofoletgrupet e kontratave të risigurimit të mbajtura (shih paragrafin 65(b)~~65(a)~~) në vlerën kontabël (neto) të portofolevegrupeve të kontratave të risigurimit të mbajtura.

Janë ndryshuar paragrafët 83, 86 dhe 88–89, si dhe është shtuar paragrafi 87A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Njohja dhe paraqitja në pasqyrën (pasqyrat) e performancës financiare (paragrafët B120–B136)

...

Rezultati nga shërbimi i sigurimit

83 **Njësia ekonomike do të paraqesë në fitim ose humbje të ardhurat e sigurimit që vijnë nga grupet e kontratave të sigurimit të emetuara. Të ardhurat e sigurimit do të përfshijnë provizionin për ~~mbulimin dhe shërbimet e tjera~~ shërbimet që vijnë nga grupi i kontratave të sigurimit me një shumë e cila pasqyron konsideratën që njësia ekonomike pret të marrë në këmbim të këtyre shërbimeve. Në paragrafët B120–B127specifikohet mënyra se si njësia ekonomike mat të ardhurat e sigurimit.**

...

86 Njësia ekonomike mund të paraqesë të ardhurat ose shpenzimet nga një grup kontratash risigurimi të mbajtura (shih paragrafët 60–70A~~70~~), të ndryshme nga të ardhurat ose shpenzimet financiare, si një shumë e vetme; ose njësia ekonomike mund të paraqesë veçmas shumat e rikuperuara nga risiguruesi dhe një shpërndarje të primeve të paguara të cilat së bashku japin një shumë të barabartë me atë shumë të vetme. Nëse njësia ekonomike paraqet veçmas shumat e rikuperuara nga risiguruesi dhe një shpërndarje të primeve të paguara, ajo do të:

(a) ...

(b) trajtojë shumat që pret të marrë nga risiguruesi të cilat nuk varen nga kërkesat shtesë të kontratave në fjalë (për shembull disa lloje komisionesh dorëzimi) si një pakësim në primet për t'u paguar tek risiguruesi; ~~dhe~~

(ba) trajtojë shumat e njohura lidhur me rikuperimin e humbjeve duke zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe 66A–66B si shuma të rikuperuara nga risiguruesi; dhe

(c) mos paraqesë shpërndarjen e primeve të paguara si një pakësim në të ardhurat.

Të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi (shih paragrafët B128–B136)

...

87A **Njësia ekonomike do të zbatojë:**

(a) **paragrafin B117A për të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit që vijnë nga zbatimi i paragrafit B115 (zbutja e rrezikut); dhe**

(b) **paragrafët 88 dhe 89 për të gjitha të ardhurat ose shpenzimet e tjera financiare të sigurimit.**

88 **Kur zbatohet paragrafi 87A(b), me përjashtim~~Me përjashtim~~ të rastit kur zbatohet paragrafi 89, njësia ekonomike do të bëjë një zgjedhje të politikës kontabël midis:**

...

89 **Kur zbatohet paragrafi 87A(b), për~~Për~~ kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, për të cilat njësia ekonomike mban zërin bazë, ajo do të bëjë një zgjedhje të politikës kontabël midis:**

...

Dhënia e informacioneve shpjeguese

...

Janë ndryshuar paragrafët 97, 99–101, 103–105, 106–107 dhe 109, si dhe janë shtuar paragrafët 105A–105B dhe 109A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Shpjegimi i shumave të njohura

97 Nga kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 98–109A~~109~~, vetëm ato të paraqitura në paragrafët 98–100, 102–103, 105–105B dhe 109A ~~dhe 102–105~~ janë të zbatueshme për kontratat në të cilat përdoret metoda e shpërndarjes së primit. Nëse njësia ekonomike përdor metodën e shpërndarjes së primit, ajo do të japë informacion shpjegues edhe:

...

99 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues të mjaftueshëm mbi rakordimet për t'iu mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare identifikimin e ndryshimeve nga flukset e mjeteve monetare dhe shumat të cilat janë njohur në pasqyrën (pasqyrat) e performancës financiare. Për të plotësuar këtë kërkesë, njësia ekonomike do:

(a) të paraqesë në një tabelë rakordimet e përmendura në paragrafët 100–105B~~105~~; dhe

(b) të paraqesë për secilin rakordim, vlerat kontabël (neto) në fillim dhe në fund të periudhës, të zbërthyera në një total për portofoletgrupet e kontratave që janë aktive dhe në një total për portofoletgrupet e kontratave që janë detyrime, të cilat barazojnë shumat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar duke zbatuar paragrafin 78.

100 Njësia ekonomike do të japë veçmas informacione shpjeguese mbi rakordimin e tepricave të çeljes dhe të mbylljes për:

...

(c) secilin nga detyrimet për kërkesat shtesë të pësuara. Për kontratat e sigurimit tek të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A~~70~~, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues veçmas për:

...

101 Për kontratat e sigurimit të ndryshme nga ato tek të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A~~70~~, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues edhe mbi rakordimin e tepricave të çeljes dhe të mbylljes për secilin nga sa vijon:

...

103 Në rakordimet e kërkuara në paragrafin 100, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shtesë për secilën nga shumat në vijim të lidhura me ~~shërbimet e sigurimit~~ shërbimet:

...

(c) përbërësit investim të përjashtuar nga të ardhurat e sigurimit dhe shpenzimet e shërbimit të sigurimit (e kombinuar me rimbursimin e primeve, me përjashtim të rastit kur primet paraqiten si pjesë e flukseve monetare në periudhën e cilësuar në paragrafin 105(a)(i)).

104 Në rakordimet e kërkuara në paragrafin 101, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shtesë për secilën nga shumat në vijim të lidhura me ~~shërbimet e sigurimit~~ shërbimet:

(a) ...

(b) ndryshimet e lidhura me shërbimin aktual, d.m.th:

(i) ...

(ii) ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar, i cili nuk lidhet me shërbimin e ardhshëm ose të shkuar; dhe

(iii) *rregullimet për eksperiencë* (shih paragrafët B97(c) dhe B113(a)), duke përjashtuar shumat e lidhura me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar të përfshirë në pikën (ii).

(c) ...

105 Për të plotësuar rakordimet në paragrafët 100–101, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shpjegues edhe për secilën nga shumat në vijim të palidhura me ~~shërbimet e sigurimit~~ shërbimet e ofruara gjatë periudhës:

...

105A Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim të tepricave në çelje dhe në mbyllje të aktiveve për flukset monetare të blerjes së sigurimit të njohura duke zbatuar paragrafin 28B. Njësia ekonomike do të grupojë informacionin për rakordim në një nivel që është në pajtim me rakordimin e kontratave të sigurimit, duke zbatuar paragrafin 98.

105B Njësia ekonomike do të japë informacion veçmas në rakordimin e kërkuar nga paragrafi 105A për çdo humbje nga zhvlerësimi dhe çdo anulim të humbjeve nga zhvlerësimi të njohura duke zbatuar paragrafin 28E–28F.

106 Për kontratat e sigurimit të emetuara, të ndryshme nga ato për të cilat zbatohet metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 , njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një analizë të të ardhurave të sigurimit të njohura gjatë periudhës duke përfshirë:

(a) shumat që lidhen me ndryshimet në detyrimin për mbulimin e mbetur siç specifikohet në paragrafin B124, duke paraqitur veçmas:

(i) ...

(ii) ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar, siç specifikohet në paragrafin B124(b); ~~dhe~~

(iii) shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës) për shkak të transferimit të kontratës së sigurimit të shërbimit gjatë periudhës, siç specifikohet në paragrafin B124(c); dhe~~.~~

(iv) shumat e tjera, nëse ka, për shembull rregullimet për eksperiencë për primet e marra të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimin e ardhshëm, siç specifikohet në paragrafin B124(d).

(b) shpërndarja e pjesës së primeve që lidhen me rikuperimin e flukseve monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin B125).

107 Për kontratat e sigurimit të ndryshme nga ato për të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A~~70~~, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi efektin në pasqyrën e pozicionit financiar veçmas për kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e risigurimit të mbajtura të cilat janë njohur fillimisht gjatë periudhës, duke treguar efektin e tyre në njohjen fillestare në:

...

109 Për kontratat e sigurimit të ndryshme nga ato për të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A~~70~~, njësia ekonomike do të japë informacion ~~shpjegues~~ se kur pret të njohë marzhin e kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës raportuese në fitim ose humbje~~, ose~~ nga ana sasiore, me hapësira kohore të përshtatshme ~~ose duke dhënë informacion cilësor~~. Ky informacion duhet të jepet veçmas për kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e risigurimit të mbajtura.

109A Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues sasior me hapësira kohore të përshtatshme, kur pret të mosnjohë (çregjistrojë) një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C.

...

Është ndryshuar paragrafi 114. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Shumat e përkohshme

114 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese, të cilat u mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të identifikojnë efektin e grupeve të kontratave të sigurimit të matura në datën e tranzicionit, duke zbatuar metodën e modifikuar retrospektive (shih paragrafët C6–C19A~~C19~~) ose metodën e vlerës së drejtë (shih paragrafët C20–C24B~~C24~~) në marzhin e kontraktuar të shërbimit dhe të ardhurat nga sigurimi në periudhat pasuese. Prandaj njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për rakordimin mbi marzhin e kontraktuar të shërbimit duke zbatuar paragrafin 101(c) dhe për shumën e të ardhurës nga sigurimi duke zbatuar paragrafin 103(a), veçmas për:

...

Është ndryshuar paragrafi 117. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Gjykime të rëndësishme kur zbatohet SNRF 17

117 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi gjykimet e rëndësishme dhe ndryshimet në gjykime të bëra gjatë zbatimit të SNRF 17. Në mënyrë specifike, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi të dhënat fillestare, supozimet dhe teknikat e përdorura të vlerësimit, duke përfshirë:

...

(c) metodën e përdorur, në madhësinë e mbetur pa mbuluar në pikën (a):

...

(iii) për të përcaktuar normat e skontimit; ~~dhe~~

(iv) për të përcaktuar përbërësit investim; dhe~~.~~

(v) për të përcaktuar peshën relative të përfitimeve të ofruara nga mbulimi i sigurimit dhe shërbimi i kthimit të investimit, ose nga mbulimi i isigurimit dhe shërbimi i lidhur me investimin (shih paragrafët B119–B119B).

...

Janë ndryshuar paragrafët 128–129 dhe 132. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Natyra dhe madhësia e rreziqeve që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17

...

Rreziqet e sigurimit dhe të tregut—analiza e ndjeshmërisë

128 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues rreth ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në variablat e rrezikut~~ekspozimet~~ që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17. Për të plotësuar këtë kërkesë, njësia ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:

(a) një analizë të ndjeshmërisë, e cila tregon sesi fitimi ose humbja dhe kapitali i vet do të ndikoheshin nga ndryshimet në variablat e rrezikut~~ekspozimet~~ që ishin të mundshme në mënyrë të arsyeshme në fund të periudhës së raportimit:

(i) ...

(ii) për çdo tip të rrezikut të tregut—në një mënyrë që shpjegon lidhjen mes ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në variblat e rrezikut~~ekspozimet~~ që vijnë nga kontratat e sigurimit dhe të atyre që vijnë nga aktivet financiare të mbajtura nga njësia ekonomike.

...

129 Nëse njësia ekonomike përgatit një analizë të ndjeshmërisë e cila tregon sesi ndikohen shumat e ndryshme nga ato të cilësuara në paragrafin 128(a) nga ndryshimet në variblat e rrezikut~~ekspozimet~~ dhe e përdor këtë analizë ndjeshmërie për të menaxhuar rreziqet që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike mund ta përdorë këtë analizë ndjeshmërie në vend të analizës të cilësuar në paragrafin 128(a). Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese edhe për:

...

Rreziku i likuiditetit—informacione të tjera

132 Për rrezikun e likuiditetit që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike do të japë si informacion:

(a) ...

(b) analiza maturimi të veçanta për portofoletgrupet e kontratave të sigurimit të emetuara që janë detyrime dhe portofoletgrupet e kontratave të risigurimit të mbajtura që janë detyrime dhe që tregojnë të paktën flukset monetare neto të portofolevegrupeve për secilin nga pesë vitet e para pas datës së raportimit dhe në total përtej pesë viteve të para. Nuk kërkohet që njësia ekonomike

të përfshijë në këto analiza detyrimet për mbulimin e mbetur të matur duke zbatuar paragrafët 55–59 dhe paragrafët 69–70A. Analizat mund të jenë në formën e:

...

(c) shumave që janë të pagueshme menjëherë, duke shpjeguar lidhjen mes shumave të tilla dhe vlerës kontabël (neto) të portofolevegrupeve përkatëse të kontratave, nëse për dhënien e informacioneve nuk është zbatuar pika (b) e këtij paragrafi.

Ndryshime në Shtojcën A—Termat e përkufizuar

Janë ndryshuar përkufizimet e 'marzhi i kontraktuar i shërbimit', 'periudha e mbulimit', 'grupi i kontratave të sigurimit' dhe 'flukset monetare të blerjes së sigurimit'. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

marzhi i shërbimit i kontraktuar — Një përbërës i vlerës kontabël (neto) të aktivit ose të detyrimit për një **grup kontratash sigurimi** i cili paraqet fitimin e parealizuar që njësia ekonomike do të njohë kur të ofrojë **shërbimet e kontratës së sigurimit**shërbimet sipas **kontratave të sigurimit** në grup.

periudha e mbulimit — Periudha gjatë së cilës njësia ekonomike ofron **shërbimet e kontratës së sigurimit**mbulimin për **ngjarjet e siguruara**. Kjo periudhë përfshin **shërbimet e kontratës së sigurimit** që lidhet mbulimin që lidhet me të gjitha primet brenda kufijve të **kontratës së sigurimit**.

...

grupi i kontratave të sigurimit — Një grup **kontratash sigurimi** që vijnë nga ndarja e një **portofoli kontratash sigurimi** në të paktën disa kontrata të emetuaranënshkruara brenda një periudhe jo më të gjatë se një vit dhe që në njohjen fillestare:

(a) janë me kushte rënduese, nëse ka;

(b) nuk kanë shumë mundësi që të bëhen me kushte rënduese më pas, nëse ka; ose

(c) nuk përfshihen në pikën (a) ose (b), nëse ndodh.

flukset monetare të blerjes së sigurimit — Flukset monetare që vijnë nga kostot e shitjes, nënshkrimit dhe fillimit të **një grupi kontratash sigurimi** (të emetuara ose që pritet të emetohen) që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek **portofoli i kontratave të sigurimit** të cilit i përket grupi. Flukse të tilla monetare përfshijnë flukset që nuk janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek kontratat individuale ose **grupet e kontratave të sigurimit** brenda portofolit.

...

Pas përkufizimit të 'kontratë sigurimi' është shtuar një përkufizim i ri. Teksti i ri është i nënvizuar.

shërbime të kontratës së sigurimit — Shërbimet në vijim, që njësia ekonomike i ofron tek një **policë mbajtës** i një **kontrate sigurimi**:

(a) mbulim për një **ngjarje të siguruar** (mbulimi i sigurimit);

(b) për **kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë**, gjenerimi i një kthimi nga investimi për policë mbajtësin nëse kjo është e zbatueshme (shërbim kthim investimi); dhe

(c) për **kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë**, menaxhimi i zërave bazë (të përfshirë) për llogari të **policë mbajtësit** (shërbime të lidhura me investimin).

...

Janë ndryshuar përkufizimet e 'përbërësi investim', 'detyrimi për kërkesat shtesë të pësuara' dhe 'detyrimi për mbulimin e mbetur'. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

përbërësi investim Shumat që njësia ekonomike, sipas një **kontrate sigurimi** detyrohet t'i kthejë një **policë mbajtësi** në çdo rast, pavarësisht nëse **ngjarja e siguruar** ndodh~~edhe nëse një **ngjarje e siguruar** nuk ndodh~~.

...

detyrimet për kërkesat shtesë të pësuara Detyrimi i njësisë ekonomike për të:

(a) hetuar dhe paguar kërkesat shtesë të vlefshme për **ngjarjet e siguruara**, të cilat kanë ndodhur tashmë, duke përfshirë ngjarjet që kanë ndodhur por për të cilat kërkesat shtesë nuk janë raportuar ende, si dhe shpenzimet e tjera të sigurimit të ndodhura; dhe~~.~~

(b) shumat e paguara që nuk janë përfshirë në pikën (a) dhe që lidhen me:

(i) **shërbimet e kontratës së sigurimit**, që janë ofruar tashmë; ose

(ii) çdo **përbërës investimi** ose ndonjë shumë tjetër që nuk lidhet me ofrimin e **shërbimeve të kontratës së sigurimit** dhe që nuk përfshihen në **detyrimin për mbulimin e mbetur**.

detyrimet për mbulimin e mbetur Detyrimi i njësisë ekonomike për të:

(a) hetuar dhe paguar kërkesat shtesë të vlefshme sipas **kontratave të sigurimit** ekzistuese për **ngjarjet e siguruara** që nuk kanë ndodhur ende (d.m.th detyrimi që lidhet me pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit~~**periudhës së mbulimit**~~); dhe~~.~~

(b) paguajë shumat sipas **kontratave të sigurimit** ekzistuese që nuk janë përfshirë në pikën (a) dhe që lidhen me:

(i) **shërbimet e kontratës së sigurimit** ende të pa ofruara (d.m.th. detyrime që lidhen me ofrimin në të ardhmen të **shërbimeve të sigurimit të kontratës**); ose

(ii) çdo **përbërës investimi** ose ndonjë shumë tjetër që nuk lidhet me ofrimin e **shërbimeve të kontratës së sigurimit** dhe që nuk janë përfshirë në **detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara**.

...

Ndryshime në Shtojcën B—Udhëzime për zbatim

Është ndryshuar paragrafi B1. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

B1 Kjo shtojcë shërben si udhëzues mbi sa vijon:

...

(ba) çdo aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin B35A–B35D);

(c) matja (shih paragrafët B36–B119F~~B119~~);

...

Janë ndryshuar paragrafët B5 dhe B12. Teksti i ri është i nënvizuar.

Përkufizimi i një kontrate sigurimi (Shtojca A)

...

Ngjarje e ardhshme e pasigurt

...

B5 Disa kontrata sigurimi mbulojnë ngjarje që kanë ndodhur tashmë, por efekti financiar i të cilave është ende i pasigurt. Një shembull është një kontratë sigurimi e cila ofron mbulim sigurimi ndaj zhvillimeve të pafavorshme të një ngjarjeje që tashmë ka ndodhur. Në kontrata të tilla, ngjarja e siguruar është përcaktimi i kostos së fundit të këtyre kërkesave shtesë.

...

Dallimi mes rrezikut të sigurimit dhe rreziqeve të tjera

...

B12 Përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet një efekti negativ mbi policë mbajtësin. Përkufizimi nuk e kufizon pagesën nga njësia ekonomike në një shumë të barabartë me efektin financiar të ngjarjes negative. Për shembull, përkufizimi përfshin mbulimin 'i ri për të vjetrin' të sigurimit që i paguan policë mbajtësit një shumë e cila lejon zëvendësimin e një aktivi të përdorur dhe të dëmtuar me një të ri. Në mënyrë të ngjashme, përkufizimi nuk kufizon pagesën sipas një kontrate të sigurimit të jetës, në humbjen financiare të pësuar nga personat në ngarkim të të larguarit nga jeta dhe as nuk përjashton kontratat që specifikojnë pagimin e shumave të parapërcaktuara për të caktuar sasinë e humbjes së shkaktuar nga vdekja ose një aksident.

...

Janë ndryshuar paragrafët B33–B35. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Premtimet për të transferuar mallra ose shërbime~~jo-sigurimi~~ të dallueshme të ndryshme nga shërbimet e kontratës së sigurimit (paragrafi 12)

B33 Paragrafi 12 kërkon që njësia ekonomike të veçojë nga kontrata e sigurimit premtimin për të transferuar mallra ose shërbime ~~jo-sigurimi~~ të dallueshme të ndryshme nga shërbimet e kontratës së sigurimit tek një policë mbajtës. Me qëllim veçimin, njësia ekonomike nuk do të marrë në konsideratë aktivitetet që ajo duhet të ndërmarrë për të përmbushur kontratën me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike transferon një mall ose shërbim të ndryshëm nga shërbimet e kontratës së sigurimit tek policë mbajtësi ndërsa ndodhin këto aktivitete. Për shembull, njësia ekonomike mund të duhet të kryejë detyra të ndryshme administrative për të lidhur një kontratë. Realizimi i këtyre detyrave nuk transferon një shërbim tek policë mbajtësi, ndërsa kryhen detyrat.

B34 Një mall ose një shërbim ~~jo-sigurimi~~ i ndryshëm nga një shërbim i kontratës së sigurimit i premtuar tek një policë mbajtës është i dallueshëm nëse policë mbajtësi mund të përfitojë ose nga vetë malli apo shërbimi ose së bashku me burimet e tjera të gatshme për t'u përdorur nga policë mbajtësi. Burime të gatshme për t'u përdorur janë mallrat apo shërbimet të cilat janë shitur veçmas (nga njësia ekonomike ose njësi të tjera) ose burime, të cilat policë mbajtësi tashmë i ka marrë (nga njësia ekonomike ose nga transaksione apo ngjarje të tjera).

B35 Një mall apo shërbim ~~jo-sigurimi~~ i ndryshëm nga një shërbim kontrate sigurimi i premtuar tek një policë mbajtës nuk është i dallueshëm nëse:

(a) ...

(b) njësia ekonomike ofron një shërbim të rëndësishëm në integrimin e mallit ose shërbimit ~~jo-sigurim~~ me përbërësit sigurim.

Janë shtuar paragrafët B35A–B35D si dhe një titull mbi paragrafin B35A. Teksti i ri është i nënvizuar.

Flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafët 28A–28F)

B35A Për të zbatuar paragrafin 28A, njësia ekonomike do të përdorë një metodë sistematike dhe racionale për të shpërndarë:

(a) flukset monetare të blerjes së sigurimit të ngarkueshme drejtpërdrejtë tek një grup kontratash sigurimi:

(i) ndaj atij grupi; dhe

(ii) ndaj grupeve që do të përfshijnë kontratat e sigurimit, të cilat priten të dalin nga rinovimi i kontratave të sigurimit në atë grup.

(b) flukset monetare të blerjes së sigurimit të ngarkueshme drejtpërdrejtë tek një portofol i kontratave të sigurimit, të ndryshme nga ato në pikën (a), tek grupet e kontratave në portofol.

B35B Në fund të çdo periudhe raportuese, njësia ekonomike do të rishikojë shumat e shpërndara siç specifikohet në paragrafin B35A për të pasqyruar çdo ndryshim në supozimet që përcaktojnë të dhënat bazë (inputet) të metodës së shpërndarjes të përdorur. Njësia ekonomike nuk do të ndryshojë shumat e shpërndara tek një grup i kontratave të sigurimit pasi të gjitha kontratat të jenë shtuar në grup (shih paragrafin B35C).

B35C Njësia ekonomike mund të shtojë kontrata sigurimi në një grup kontratash sigurimi përgjatë më shumë se një periudhe raportimi (shih paragrafin 28). Në të tilla rrethana, njësia ekonomike do të çregjistrojë (mos njohë) pjesën e aktivit për flukset monetare të blerjes së sigurimit që lidhet me kontratat e sigurimit të shtuara në grup në atë periudhë dhe do të vazhdojë të njohë një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit në masën që aktivi lidhet me kontratat e sigurimit që priten të shtohen në grup në një periudhë raportuese të ardhshme.

B35D Për të zbatuar paragrafin 28E:

(a) njësia ekonomike do të njohë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje dhe do të pakësojë vlerën kontabël (neto) të një aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit në mënyrë që vlera kontabël (neto) e aktivit nuk tejkalon flukset monetare neto të pritshme të grupit përkatës të kontratave të sigurimit, të përcaktuar duke zbatuar paragrafin 32(a).

(b) kur njësia ekonomike shpërndan flukset monetare të blerjes së sigurimit tek grupet e kontratave të sigurimit duke zbatuar paragrafin B35A(a)(ii), njësia ekonomike do të njohë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje dhe do të pakësojë vlerën kontabël (neto) të aktiveve përkatëse për flukset monetare të blerjes së sigurimit në masën që:

(i) njësia ekonomike pret që këto flukse monetare të blerjes së sigurimit të tejkalojnë flukset hyrëse monetare për rinovimet e pritshme të përcaktuara duke zbatuar paragrafin 32(a); dhe

(ii) teprica e përcaktuar duke zbatuar pikën (b)(i) nuk është njohur ende si një humbje nga zhvlerësimi duke zbatuar pikën (a).

Paragrafët B64–B66 dhe B71–B72 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi B66A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Matja (paragrafët 29–71)

Vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare(paragrafët 33–35)

...

Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të kontratës (shih paragrafi 34)

...

B64 Paragrafi 34 i referohet aftësisë praktike të njësisë ekonomike për të vendosur një çmim në një datë të ardhshme (data e rinovimit), që pasqyron plotësisht rreziqet në kontratë nga ajo datë. Njësia ekonomike e ka atë aftësi praktike në mungesë të pengesave që e ndalojnë njësinë ekonomike të vendosë të njëjtin çmim që do të vendoste për një kontratë të re, me të njëjtat karakteristika si kontrata ekzistuese e emetuar në atë datë ose nëse mund të ndryshonte përfitimet për të qenë në përputhje me çmimin që do të vendoste. Në mënyrë të ngjashme, njësia ekonomike ka aftësi praktike për të vendosur një çmim kur ajo mund të

rivendosë çmimin e një kontrate ekzistuese në mënyrë që çmimi të pasqyrojë ndryshimet e përgjithshme në rreziqet e një portofoli kontratash sigurimi, edhe nëse çmimi i vendosur për secilin policë mbajtës individual nuk pasqyron ndryshimin në rrezik për atë policë mbajtës specifik. Kur njësia ekonomike vlerëson nëse ka aftësinë praktike për të vendosur një çmim që pasqyron plotësisht rreziqet në kontratë ose portofol, ajo do të marrë në konsideratë të gjitha rreziqet që duhet të ketë parasysh kur nënshkruan kontrata ekuivalente në datën e rinovimit për shërbimin~~mbulimin~~ e mbetur. Njësia ekonomike do të rivlerësojë kufijtë e një kontrate sigurimi për të përfshirë efektin e ndryshimeve në rrethanat e të drejtave dhe detyrimeve themelore të saj, kur përcakton vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare në fund të periudhës raportuese.

B65 Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të një kontrate sigurimi janë ato që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, përfshirë flukset monetare për të cilat njësia ekonomike mund të vendosë lirisht mbi shumën ose kohën. Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të kontratës përfshijnë:

...

(ka) kostot që do të pësojë njësia ekonomike kur:

(i) realizon aktivitetin investues, në masën që njësia ekonomike e realizon atë aktivitet për të rritur përfitimet nga mbulimi i sigurimit për policë mbajtësit. Aktivitetet investuese rrisin përfitimet për mbulimin e sigurimit nëse njësia ekonomike i realizon ato aktivitete duke pritur që të gjenerojë një kthim investimi për të cilin policë mbajtësit do të përfitojnë nëse ndodh ngjarja e siguruar.

(ii) ofron shërbime kthim investimi tek policë mbajtësit e kontratave të sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së lirë (shih paragrafin B119B).

(iii) ofron shërbime kthim investimi tek policë mbajtësit e kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë.

...

B66 Flukset monetare në vijim nuk do të përfshihen kur vlerësohen flukset monetare që do të vijnë ndërsa njësia ekonomike përmbush një kontratë sigurimi ekzistuese:

...

(f) pagesat dhe arkëtimet e tatimit mbi të ardhurat që siguruesi nuk paguan apo arkëton në mirëbesim (në cilësinë e mbajtësit në besueshmëri) ose që nuk janë të ngarkueshme në mënyrë specifike tek policë mbajtësi sipas kushteve të kontratës.~~ Pagesa dhe arkëtime të tilla njihen, maten dhe paraqiten veçmas duke zbatuar SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*.~~

...

B66A Para njohjes së një grupi kontratash sigurimi, njësisë ekonomike mund t'i kërkohet të njohë një aktiv ose detyrim për flukset monetare të lidhura me grupin e kontratave të sigurimit të ndryshme nga flukset monetare të blerjes së sigurimit ose për shkak të ndodhjes së fluksit monetar, ose për shkak të kërkesave të një SNRF-je tjetër. Flukset monetare lidhen me grupin e kontratave të sigurimit nëse ato do të ishin përfshirë në flukset monetare të realizuara në datën e njohjes fillestare të grupit dhe nëse do të ishin paguar ose arkëtuar pas asaj date. Për të zbatuar paragrafin 38(c)(ii) njësia ekonomike do të çregjistrojë (mosnjohë) një aktiv ose detyrim të tillë në masën që aktivi apo detyrimi nuk do të njihet veçmas nga grupi i kontratave te sigurimit nëse fluksi monetar ose zbatimi i SNRF-së ka ndodhur në datën e njohjes fillestare të grupit të kontratave të sigurimit.

Kontratat me flukse monetare që ndikojnë ose ndikohen nga flukset monetare të policë mbajtësve të kontratave të tjera

...

B71 Edhe pasi të jenë ofruar të gjithë shërbimet e kontratës së sigurimit~~ mbulimi i~~ të kontratave në një grup, flukset monetare të realizuara mund të përfshijnë ende pagesa të pritshme për t'u bërë tek policë mbajtësit aktualë në grupet e tjera ose tek policë mbajtës të ardhshëm. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të vazhdojë të shpërndajë flukse të tilla monetare të realizuara tek grupe specifike, por në vend të kësaj mund të njohë dhe masë një detyrim për të tilla flukse monetare të realizuara që vijnë nga të gjitha grupet.

Normat e skontimit (paragrafi 36)

B72 Kur zbaton SNRF 17, njësia ekonomike do të përdorë normat e skontimit në vijim:

...

(c) për të matur ndryshimet në marzhin e kontraktuar të shërbimit në zbatim të paragrafëve B96(a)–B96(b) dhe B96(d)~~paragrafit B96(a)–B96(c)~~ për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë—normat e skontimit duke zbatuar paragrafin 36, të përcaktuara në njohjen fillestare;

...

Janë ndryshuar paragrafët B93–B95 dhe është degëzuar paragrafi B95 duke krijuar paragrafin e ri B95A. Janë shtuar paragrafët B95B–B95F si dhe një titull mbi paragrafin B95E. Teksti i ri është i nënvizuar.

Njohja fillestare e transferimit të kontratave të sigurimit dhe kombinimet e biznesit (paragrafi 39)

B93 Nëse njësia ekonomike blen kontrata sigurimi të emetuara ose kontrata risigurimi të mbajtura në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes, ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 14–24 për të identifikuar grupet e kontratave të blera, njëlloj sikur të kishte lidhur kontratat në datën e transaksionit.

B94 Njësia ekonomike do të përdorë konsideratën e marrë ose të paguar për kontratat si një vlerësim për primet e marra. Konsiderata e marrë ose e paguar për kontratat përjashton konsideratën e marrë ose të paguar për ndonjë aktiv apo detyrim tjetër të blerë në të njëjtin transaksion. Në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, konsiderata e marrë ose e paguar është vlera e drejtë e kontratës në atë datë. Në përcaktimin e kësaj vlere të drejtë, njësia ekonomike nuk do të zbatojë paragrafin 47 të SNRF 13 (që lidhet me tiparet e kërkuara).

B95 Me përjashtim të rastit kur zbatohet metoda e shpërndarjes së primit për detyrimin e mbulimit të mbetur e paragrafëve 55–59 dhe 69–70A, në njohjen fillestare marzhi i kontraktuar i shërbimit llogaritet duke zbatuar paragrafin 38 për kontratat e sigurimit të blera, të emetuara dhe paragrafin 65 për kontratat e risigurimit të blera, të mbajtuara duke përdorur konsideratën e marrë ose të paguar për kontratat si një vlerësim për primet e marra ose të paguara në datën e njohjes fillestare.

B95A Nëse kontratat e blera të sigurimit janë me kushte rënduese, në zbatim të paragrafit 47, njësia ekonomike do të njohë tejkalimet e flukseve monetare të realizuara ndaj konsideratës së paguar ose të marrë si pjesë të emrit të mirë ose të fitimit nga një blerje me okazion për kontratat e blera në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, ose si një humbje në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje) për kontratat e blera në një transferim. Njësia ekonomike do të krijojë një përbërës humbjeje për detyrimin e mbulimit të mbetur për atë tejkalim, si dhe në zbatim të paragrafëve 49–52 do të shpërndajë tek ai përbërës humbjeje ndryshimet e mëpasshme në flukset monetare të realizuara.

B95B Për çdo grup kontratash risigurimi të mbajtuara për të cilat zbatohen paragrafët 66A–66B, njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbjeje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e transaksionit duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit të përfshira në datën e transaksionit; dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit të përfshira që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura në datën e e transaksionit.

B95C Njësia ekonomike do të njohë shumën e përbërësit rikuperim humbjeje të përcaktuar në zbatim të paragrafit B95B si pjesë e emrit të mirë ose e fitimit nga blerja me okazion e kontratave të risigurimit të mbajtura të blera në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3 ose si një e ardhur në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje) për kontratat e blera në transferim.

B95D Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e transaksionit, njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin B95B njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit, që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

Aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit

B95E Nëse njësia ekonomike blen kontrata sigurimi të emetuara në një transferim të kontratave të sigurimit që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike do të njohë një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit me vlerën e drejtë në datën e transaksionit të të drejtave për të marrë:

(a) kontrata të ardhshme të sigurimit që janë rinovime të kontratave të sigurimit të njohura në datën e transaksionit; dhe

(b) kontrata të ardhshme sigurimi, të ndryshme nga ato në pikën (a), pas datës së transaksionit pa paguar përsëri flukset monetare të blerjes së sigurimit që blerësi ka paguar tashmë dhe që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek portofoli përkatës i kontratave të sigurimit.

B95F Në datën e transaksionit, shuma e çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit nuk do të përfshihet në matjen e grupit të blerë të kontratave të sigurimit duke zbatuar paragrafët B93–B95A.

Janë ndryshuar paragrafët B96–B97. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (paragrafi 44)

B96 Për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, paragrafi 44(c) kërkon rregullimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash sigurimi për ndryshimet në flukset monetare të realizuara që lidhen me shërbimin e ardhshëm. Këto ndryshime përfshijnë:

(a) rregullime për eksperiencën që vijnë nga primet e marra gjatë periudhës të lidhura me shërbimin e ardhshëm dhe flukset monetare përkatëse, të tilla si flukset monetare të blerjes së sigurimit dhe taksat e bazuara në prim, të matura me normën e skontimit të specifikuar në paragrafin B72(c).~~;~~

(b) ndryshimet në vlerësimet e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të detyrimit për mbulimin e mbetur, me përjashtim të atyre të përshkruara në paragrafin B97(a), të matur me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(c).~~;~~

(c) diferencat mes çdo përbërësi investim që pritet të bëhet i pagueshëm gjatë periudhës dhe përbërësit aktual investim që bëhet i pagueshëm gjatë periudhës. Këto diferenca përcaktohen duke krahasuar (i) përbërësin aktual të investimit që bëhet i pagueshëm gjatë periudhës me (ii) pagesën gjatë periudhës që pritej të ishte në fillim të periudhës plus çdo të ardhur ose shpenzim financiar të sigurimit të lidhur me atë pagesë të pritshme para se të bëhet e detyrueshme për t'u paguar. ~~të matur me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(c); dhe~~

(ca) diferencat mes çdo huaje ndaj policë mbajtësit që pritet të bëhet e ripagueshme gjatë periudhës dhe huasë aktuale ndaj policë mbajtësit që bëhet e ripagueshme gjatë periudhës. Këto diferenca përcaktohen duke krahasuar (i) huanë aktuale ndaj një policë mbajtësi që bëhet e ripagueshme gjatë periudhës me (ii) ripagesën gjatë periudhës që pritej të ishte në fillim të periudhës plus çdo të ardhur ose shpenzim financiar të sigurimit të lidhur me atë ripagesë të pritshme para se të bëhet e detyrueshme për t'u ripaguar.

(d) ndryshimet në rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar që lidhen me shërbimin e ardhshëm. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbërthejë ndryshimin në rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar mes (i) një ndryshimi të lidhur me rrezikun jo-financiar dhe (ii) efektit në kohë të parasë dhe ndryshimeve në vlerën në kohë të parasë. Nëse njësia ekonomike bën zbërthime të tilla, ajo duhet të rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit për ndryshimin e lidhur me rrezikun jo-financiar, të matur me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B27(c).

B97 Njësia ekonomike nuk do ta rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit për një grup kontratash sigurimi pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për ndryshimet vijuese në flukset monetare të realizuara, sepse ato nuk lidhin me shërbimin e ardhshëm:

(a) efektin në vlerën në kohë të parasë dhe ndryshimet në vlerën në kohë të parasë si dhe efektin e rrezikut financiar dhe ndryshimeve në rrezikun financiar. Këto ndryshime përfshijnë: ~~(të qënit~~

(i) efektin, nëse ka, të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;

(ii) efektin, nëse zbërthehet, të rregullimit të rrezikut për rrezikun jo-financiar; dhe

(iii) efektin e ndryshimit në normën e skontimit.~~);~~

(b) ndryshimet në vlerësimet e flukseve monetare të realizuara të detyrimit për kërkesat shtesë të pësuara.~~; dhe~~

(c) …

…

Janë ndryshuar paragrafët B104, B107, B112, B115–B116 dhe B118. Është shtuar paragrafi B117A. Paragrafi B101 nuk është ndryshuar por është përfshirë për lehtësi referimi. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (paragrafi 45)

B101 Kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë janë kontrata sigurimi, të cilat në thelb janë kontrata shërbimi të lidhura me investimin sipas të cilave njësia ekonomike premton një kthim nga investimi bazuar në zërat bazë. Por, ato përkufizohen si kontrata sigurimi për të cilat:

(a) kushtet kontraktuale specifikojnë se policë mbajtësit marrin pjesë në ndarjen e një grupi zërash bazë të identifikueshëm qartë (shih paragrafët B105–B106);

(b) njësia ekonomike pret që të paguajë tek policë mbajtësi një shumë të barabartë me një pjesë të rëndësishme të vlerës së drejtë të kthimeve nga zërat bazë (shih paragrafin B107); dhe

(c) njësia ekonomike pret që një pjesë e rëndësishme e ndonjë ndryshimi në shumat që duhet të paguhen tek policë mbajtësi të ndryshojnë me ndryshimin në vlerën e drejtë të zërave bazë (shih paragrafin B107).

…

B104 Kushtet në paragrafin B101sigurojnë se kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë janë kontrata sipas të cilave detyrimi i njësisë ekonomike ndaj policë mbajtësit është vlera neto e:

(a) …

(b) komisionit të ndryshueshëm (shih paragrafët B110–B118), të cilin njësia ekonomike do ta zbresë (a) në këmbim të një shërbimit të ardhshëm të ofruar nga kontrata e sigurimit që përfshin:

(i) shumën e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të zërave bazë; minus

(ii) …

…

B107 Paragrafi B101(b) kërkon që njësia ekonomike të presë që një pjesë e rëndësishme e vlerës së drejtë të kthimeve nga zërat bazë t'i paguhet policë mbajtësit dhe paragrafi B101(c) kërkon që njësia ekonomike të presë që një pjesë e rëndësishme e ndonjë ndryshimi në shumat e pagueshme tek policë mbajtësi të ndryshojë me ndryshimin në vlerën e drejtë të zërave bazë. Njësia ekonomike do:

(a) …

(b) të vlerësojë ndryshimin në shumat e paragrafëve B101(b) dhe B101(c):

(i) gjatë jetës së kontratës së sigurimit~~grupit të kontratave të sigurimit~~; dhe

(ii) …

…

B112 Ndryshimet në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike, mbi vlerën e drejtë të zërave bazë (paragrafi B104(b)(i)) lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit, duke zbatuar paragrafin 45(b).

…

Zvogëlimi i rrezikut

B115 Në madhësinë që njësia ekonomike plotëson kushtet në paragrafin B116, ajo mund të zgjedhë të mos njohë një ndryshim në marzhin e kontraktuar të shërbimit për të pasqyruar disa apo të gjitha ndryshimet në efektin e vlerës në kohë të parasë dhe rrezikut financiar në:~~ pjesën e njësisë ekonomike mbi zërat bazë (shih paragrafin B112) ose flukset monetare të realizuara të paraqitura në paragrafin B113(b).~~

(a) madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike në zërat bazë (shih paragrafin B112) nëse ajo zvogëlon efektin e rrezikut financiar në atë shumë duke përdorur derivativë ose kontrata risigurimi të mbajtura; dhe

(b) flukset monetare të realizuara të paraqitura në paragrafin B113(b) nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar në ato flukse monetare të realizuara duke përdorur derivativë, intrumenta financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, apo kontrata risigurimi të mbajtura.

B116 Për të zbatuar paragrafin B115, njësia ekonomike duhet të ketë dokumentuar më parë objektivin dhe strategjinë për menaxhimin e rrezikut për zvogëlimin e rrezikut financiar të përshkruar në paragrafin B115.~~nëpërmjet përdorimit të derivativëve për zbutjen e rrezikut financiar që vjen nga kontratat e sigurimit dhe~~ Duke zbatuar këtë objektiv dhe strategji:

~~(a) njësia ekonomike përdor një derivativ për të zbutur rrezikun financiar që vjen nga kontratat e sigurimit.~~

(a)~~(b)~~ ekziston një kompensim ekonomik mes kontratave të sigurimit dhe derivativëve, instrumenteve financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, apo kontratat e risigurimit të mbajtuara (dmth vlerat e kontratave të sigurimit dhe të atyre zërave që zvogëlojnë rrezikun~~derivativët~~ zakonisht lëvizin në drejtim të kundërt sepse u përgjigjen njëlloj ndryshimeve në rrezikun që zvogëlohet). Njësia ekonomike nuk do të marrë në konsideratë trajtimin kontabël të matjes së diferencave gjatë vlerësimit të kompensimit ekonomik.

(b)~~(c)~~ rreziku i kredisë nuk dominon kompensimin ekonomik.

...

B117A Nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar duke përdorur derivativë ose instrumente financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ajo duhet të përfshijë të ardhurën ose shpenzimet financiare të sigurimit për periudhën që vjen nga zbatimi i paragrafëve B115 në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës). Nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar duke përdorur kontratat e risigurimit të mbajtura, ajo duhet të zbatojë të njëjtën politikë kontabël për paraqitjen e të ardhurës apo shpenzimeve financiare të sigurimit që vijnë nga zbatimi i paragrafit B115 sikur njësia të zbatonte kontratat e risigurimit të mbajtuara në zbatim të paragrafëve 88 dhe 90.

B118 Nëse dhe vetëm nëse, pushojnë ~~pushon~~ së plotësuari ndonjë nga kushtet e paragrafit B116~~,~~ njësia ekonomike do~~:~~

~~(a)~~ të ndalojë zbatimin e paragrafit B115 nga ajo datë. ~~; dhe~~

~~(b)~~ Njësia ekonomike nuk do të bëjë asnjë rregullim për ndryshimet e njohura më parë në rezultat.

Paragrafi B119 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët B119A–B119B. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Njohja e marzhit të kontraktuar të shërbimit në fitim ose humbje (rezultat)

B119 Një pjesë e marzhit të kontraktuar të shërbimit për një grup kontratash sigurimi njihet në fitimin ose humbjen e secilës periudhë për të pasqyruar shërbimin e kontratave të sigurimit të ofruar sipas grupit të kontratave të sigurimit në atë periudhë (shih paragrafët 44(e), 45(e) dhe 66(e)). Shuma përcaktohet duke:

(a) identifikuar njësitë e mbuluara në grup. Numri i njësive të mbuluara në grup është sa sasia e shërbimeve të kontratës së sigurimit~~mbulimit~~ të ofruara nga kontratat në grup, të përcaktuara duke marrë në konsideratë për secilën kontratë sasinë e përfitimeve të ofruara sipas kontratës dhe periudhën e pritshme të mbulimit të saj~~kohëzgjatjen~~.

(b) shpërndarë marzhin e kontraktuar të shërbimit në fund të periudhës (para njohjes së ndonjë shume në fitim apo humbje për të pasqyruar shërbimet e kontratës së sigurimit të ofruara gjatë periudhës) në mënyrë të barabartë për çdo njësi mbulimi të ofruar në periudhën aktuale dhe që pritet të ofrohet në të ardhmen.

(c) njohur në fitim ose humbje shumën e shpërndarë tek njësitë e mbulimit të ofruara gjatë periudhës.

B119A Për të zbatuar paragrafin B119, periudha e shërbimit kthim investimi ose shërbimit të lidhur me investimin përfundon në datën ose më parë se data kur të gjitha shumat për t'u paguar policë mbajtësit aktual lidhur me

ato shërbime i janë paguar, pa marrë në konsideratë pagesat tek policë mbajtësit e ardhshëm të përfshirë në flukset monetare të realizuara duke zbatuar paragrafin B68.

B119B Kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë mund të ofrojnë një shërbim kthimi investimi, vetëm dhe vetëm nëse:

(a) ekziston përbërësi investim, ose policë mbajtësi ka të drejtë të tërheqë shumën;

(b) njësia ekonomike pret që përbërësi investim ose shuma që ka të drejtë të tërheqë policë mbajtësi, të përfshihet në kthimin nga investimi (një kthim investimi mund të jetë negativ, për shembull në një mjedis me norma negative interesi); dhe

(c) njësia ekonomike pret të realizojë aktivitet investimi për të gjeneruar kthim nga investimi.

Janë shtuar paragrafët B119C–B119F si dhe një titull mbi paragrafin BC119C. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Kontratat e risigurimit të mbajtuara—të njohura në humbje të rikuperuara nga kontratat e sigurimit bazë (paragrafët 66A–66B)

B119C Paragrafi 66A zbatohet nëse dhe vetëm nëse, kontrata e risigurimit e mbajtur hyn në fuqi para ose në të njëjtën kohë me njohjen e kontratave të sigurimit bazë me kushte rënduese

B119D Për të zbatuar paragrafin 66A, njësia ekonomike do të përcaktojë rregullimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash risigurimi të mbajtuara dhe të ardhurën që rezulton duke shumëzuar:

(a) humbjen e njohur në kontratat e sigurimit bazë; dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave risigurimit të mbajtura.

B119E Duke zbatuar paragrafët 14–22, njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe paragrafin 66A, njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e humbjes të njohur nga një grup kontratash sigurimi që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

B119F Pasi njësia ekonomike ka krijuar përbërësin rikuperim humbjeje duke zbatuar paragrafin 66B, ajo do të rregullojë përbërësin rikuperim humbjeje për të pasqyruar ndryshimet në përbërësin humbje të një grupi me kushte rënduese të kontratave të sigurimit bazë (shih paragrafët 50–52). Vlera kontabël (neto) e përbërësit rikuperim humbje nuk duhet të tejkalojë pjesën e vlerës kontabël (neto) të përbërësit humbje të grupit me kushte rënduese të kontratave të sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

Janë ndryshuar paragrafët B121, B123, B124 dhe B126, si dhe është shtuar paragrafi B123A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Të ardhurat nga sigurimi (paragrafët 83 dhe 85)

...

B121 Paragrafi 83 kërkon që shuma e të ardhurave nga sigurimi të njohura gjatë periudhës të përfshijë transferimin e shërbimeve të premtuara në një shumë e cila pasqyron konsideratën, që njësia ekonomike pret të marrë në këmbim të këtyre shërbimeve. Totali i konsideratës për një grup kontratash mbulon shumat në vijim:

(a) shumat e lidhura me dhënien e shërbimit, duke përfshirë:

(i) shpenzimet për shërbimin e sigurimit, duke përfshirë çdo shumë që lidhet me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo financiar të përfshirë në pikën (ii) dhe çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur;

(ia) shumat e lidhura me tatimin mbi të ardhurat, të cilat mund t'i ngarkohen në mënyrë specifike policë mbajtësit;

(ii) rregullimin për rrezikun jo-financiar, përjashtuar çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur; dhe

(iii) ...

(b) ...

...

B123 Gjatë zbatimit të SNRF 15, kur njësia ekonomike ofron shërbime, ajo çregjistron detyrimin për performancën e atyre shërbimeve dhe njeh të ardhurat. Në vijim, gjatë zbatimit të SNRF 17, kur njësia ekonomike ofron shërbime gjatë një periudhe ajo pakëson detyrimin për mbulimin e mbetur për shërbimin e ofruar dhe njeh të ardhurat nga sigurimi. Pakësimi i detyrimit për mbulimin e mbetur që sjell të ardhurat nga sigurimi, përjashton ndryshimet në detyrim që nuk lidhen me shërbimet e pritshme për t'u mbuluar nga konsiderata e marrë nga njësia ekonomike. Këto ndryshime janë:

(a) ndryshimet që nuk lidhen me shërbimin e ofruar gjatë periudhës, për shembull:

...

(iia) ndryshimet që vijnë nga flukset monetare të huave ndaj policë mbajtësve;

...

B123A Në masën që njësia ekonomike çregjistron një aktiv për flukset monetare të ndryshme nga flukset monetare të blerjes së sigurimit në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi (shih paragrafët 38(c)(ii) dhe B66A), ajo duhet të njohë të ardhurat dhe shpenzimet nga sigurimi për shumën e çregjistruar në atë datë.

B124 Për pasojë, të ardhurat nga sigurimi për periudhën mund të analizohen edhe si total i ndryshimeve në detyrimin për mbulimin e mbetur gjatë periudhës, që lidhet me shërbimet për të cilat njësia ekonomike pret të marrë një konsideratë. Këto ndryshime janë:

(a) shpenzimet e shërbimit të sigurimit të ndodhura gjatë periudhës (të matura me shumat e pritshme në fillim të periudhës), duke përjashtuar:

...

(iii) shumat që lidhen me taksat e bazuar në transaksione, të mbledhura për llogari të palëve të treta (të tilla si taksat mbi primet, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat mbi mallrat apo shërbimet) (shih paragrafin B65(i)); ~~dhe~~

(iv) shpenzimet e blerjes së sigurimit (shih paragrafin B125); dhe~~.~~

(v) shumën e lidhur me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar (shih pikën (b)).

...

(d) shumat e tjera, nëse ka, për shembull rregullimet për eksperiencë për primet e marra të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimin e ardhshëm (shih paragrafin B96(a)).

...

B126 Nëse njësia ekonomike zbaton metodën e shpërndarjes së primit në paragrafët 55–58, e ardhura nga sigurimi për periudhën është shuma e arkëtimeve të pritshme nga primet (duke përjashtuar çdo përbërës investim dhe duke e rregulluar për të pasqyruar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar, nëse është e mundur, duke zbatuar paragrafin 56) që i takon (shpërndahet) periudhës. Njësia ekonomike do të shpërndajë arkëtimet e pritshme të primeve tek secila periudhë e shërbimeve të kontratës së sigurimit~~mbulimi~~:

...

Janë ndryshuar paragrafët B128 dhe B134. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi (paragrafët 87–92)

B128 Paragrafi 87 kërkon që njësia ekonomike të përfshijë në të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit efektin e vlerës në kohë të parasë dhe të rrezikut financiar, si dhe ndryshimet brenda tyre~~në supozimet që lidhen me rrezikun financiar~~. Sipas SNRF 17:

(a) supozimet rreth inflacionit të bazuara në një indeks çmimesh apo normash, ose mbi çmime aktivesh me kthime të lidhura me inflacionin, janë supozime që lidhen me rrezikun financiar;~~ dhe~~

(b) supozimet rreth inflacionit të bazuara në pritshmërinë e njësisë ekonomike për ndryshime të caktuara në çmime nuk janë supozime që lidhen me rrezikun financiar; dhe~~.~~

(c) ndryshimet në matjen e një grupi kontratash sigurimi të shkaktuara nga ndryshimet në vlerën e zërave bazë (duke përjashtuar shtesat dhe tërheqjet) janë ndryshime që vijnë nga efekti i vlerës në kohë të parasë dhe i rrezikut financiar, si dhe ndryshimet brenda tyre.

...

B134 Paragrafi 89 zbatohet nëse njësia ekonomike, zgjedh ose është e detyruar të mbajë zërat bazë për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë. Nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit duke zbatuar paragrafin 89(b), ajo do të përfshijë në rezultatin e periudhës shpenzime ose të ardhura që përputhen ekzaktësisht me të ardhurat ose shpenzimet e përfshira në rezultat nga zërat bazë, duke sjellë që efekti neto i~~ të dy~~ zërave të paraqitur veçmas të jetë zero.

...

Është ndryshuar paragrafi B137 dhe titulli përkatës. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Efekti i vlerësimeve kontabël në~~Të ndërmjetme~~ pasqyrat financiare të ndërmjetme

B137 Nëse njësia ekonomike përgatit pasqyra financiare të ndërmjetme duke zbatuar SNK 34 *Raportimi financiar i ndërmjetëm*, njësia ekonomike do të zgjedhë një politikë kontabël njëlloj sikur të ndryshonte trajtimin e vlerësimeve kontabël të bëra në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme duke zbatuar SNRF 17 në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëpasshme dhe në periudhën vjetore raportuese. Njësia ekonomike do të zbatojë zgjedhjen e saj për politikën kontabël tek të gjitha grupet e kontratave të sigurimit të emetuara prej saj dhe grupet e kontratave të risigurimit që ajo mban.~~Pavarësisht kërkesës në SNK 34 *Raportim Financiar i Ndërmjetëm* që frekuenca në raportimin e njësisë ekonomike nuk do të ndikojë matjen e rezultateve vjetore të saj, njësia ekonomike nuk do ta ndryshojë trajtimin e vlerësimeve kontabël të bëra në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme kur zbaton SNRF 17 në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëpasshme ose në raportimin vjetor të periudhës.~~

Ndryshime në Shtojcën C—Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Është ndryshuar paragrafi C1. Paragrafi C2 nuk është ndryshuar por është përfshirë për lehtësi referimi. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Data e hyrjes në fuqi

C1 Njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 17 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2023 ~~2021~~ e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 17 për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Lejohet zbatimi më i hershëm, për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 9 *Instrumente Financiare*~~ dhe SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*~~ në datën e zbatimit për herë të parë të SNRF 17 ose më herët.

C2 Për shkak të kërkesave në paragrafët C1dhe C3–C33 për periudhën kalimtare:

(a) data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë SNRF 17; dhe

(b) data e tranzicionit është fillimi i periudhës vjetore raportuese menjëherë para datës së zbatimit fillestar.

Janë ndryshuar paragrafët C3–C5 dhe janë shtuar paragrafët C5A–C5B. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Periudha kalimtare

C3 Me përjashtim të rastit kur është i pazbatueshëm, ose kur zbatohet paragrafi C5A, një~~Një~~ njësi ekonomike do të zbatojë SNRF 17 në mënyrë retrospektive~~ me përjashtim të rastit kur nuk është e mundur~~, duke përjashtuar sa vijon:

(a) ...

(b) njësia ekonomike nuk do të zbatojë opsionin në paragrafin B115 për periudha raportuese përpara datës së tranzicionit~~datës së zbatimit për herë të parë të SNRF 17~~. Njësia ekonomike mund të zbatojë opsionin në paragrafin B115 në mënyrë prospektive në datën e periudhës kalimtare ose më pas nëse dhe vetëm nëse, ajo përcakton marrëdhëniet e zvogëlimit të rrezikut në atë datë që zbaton opsionin ose më parë.

C4 Për të zbatuar në mënyrë retrospektive SNRF 17, në datën e tranzicionit njësia ekonomike do të:

(a) ...

(aa) identifikojë, njohë dhe masë çdo aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit sikur SNRF 17 të ishte zbatuar gjithmonë (me përjashtimin se njësisë ekonomike nuk i kërkohet të zbatojë vlerësimin e rikuperimit të paragrafit 28E para datës së tranzicionit);

...

C5 Vetëm dhe vetëm nëse, për njësinë ekonomike është i pamundur zbatimi i paragrafit C3 për një grup kontratash sigurimi, njësia ekonomike do të zbatojë qasjet në vijim në vend të zbatimit të paragrafit C4(a):

(a) metodën e retrospektivës së modifikuar e paragrafëve C6–C19A~~C19~~, subjekt i paragrafit C6(a); ose

(b) metodën e vlerës së drejtë të paragrafëve C20–C24B~~C24~~.

C5A Pavarësisht paragrafit C5, njësia ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë metodën e vlerës së drejtë të paragrafëve C20–C24B për një grup kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë për të cilat mund të zbatojë SNRF 17 në mënyrë retrospektive, vetëm dhe vetëm nëse:

(a) njësia ekonomike zgjedh të zbatojë opsionin e zvogëlimit të rrezikut në paragrafin B115 tek grupi i kontratave të sigurimit në mënyrë prospektive nga data e tranzicionit; dhe

(b) njësia ekonomike ka përdorur derivativë, instrumente financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose kontrata risigurimi të mbajtura për të zvogëluar rrezikun financiar që vjen nga grupi i kontratave të sigurimit, siç specifikohet në paragrafin B115, para datës së tranzicionit.

C5B Nëse dhe vetëm nëse nuk është e mundur që njësia ekonomike të zbatojë paragrafin C4(aa) për një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit, njësia ekonomike do të zbatojë qasjet në vijim për matjen e aktivit për flukset monetare të blerjes së sigurimit:

(a) metodën e retrospektivës së modifikuar e paragrafëve C14B–C14D, subjekt i paragrafit C6(a); ose

(b) modelin e vlerës së drejtë në paragrafët C24A–C24B.

Janë ndryshuar paragrafët C7–C9, C11 dhe C15–C16 dhe C17. Janë shtuar paragrafët C9A, C14A–C14D, C16A–C16C dhe C17A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Metoda retrospektive e modifikuar

...

C7 Në paragrafët C9–C19A~~C19~~ paraqiten modifikimet e lejuara për zbatimin retrospektiv në fushat në vijim:

...

C8 Për të arritur objektivin e metodës së retrospektivës së modifikuar, lejohet që njësia ekonomike të përdorë secilin prej modifikimeve në paragrafët C9–C19A~~C19~~ vetëm nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm e mbështetës, të mjaftueshëm për të zbatuar metodën retrospektive.

Vlerësimet në krijimin apo në njohjen fillestare

C9 Përsa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë çështjet në vijim duke përdorur informacionin në dispozicion në datën e tranzicionit:

(a) ...

(b) nëse një kontratë sigurimi plotëson përkufizimin e kontratës së sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B101–B109;~~ dhe~~

(c) sesi të identifikojë flukset monetare të lira për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B98–B100; dhe~~.~~

(d) nëse një kontratë investimi plotëson përkufizimin e një kontrate investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17, duke zbatuar paragrafin 71.

C9A Në masën e lejuar nga paragrafin C8, njësia ekonomike do të klasifikojë si detyrim për kërkesat shtesë të pësuara një detyrim për shlyerjen e kërkesave shtesë para se një kontratë sigurimi të ishte blerë në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3.

...

Përcaktimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit ose përbërësit humbje për grupet e kontratave të sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

C11 Për sa lejohet nga paragrafi C8, për kontratat pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, njësia ekonomike në datën e tranzicionit duhet të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur (shih paragrafët 49–52) duke zbatuar paragrafët C12–C16C~~C16~~.

...

C14A Duke zbatuar paragrafin B137, njësia ekomomike mund të zgjedhë të mos ndryshojë vlerësimin kontabël të bërë në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme. Në masën e lejuar nga paragrafi C8, një njësi e tillë ekonomike do të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje në datën e tranzicionit sikur ajo të mos kishte përgatitur pasqyra financiare të ndërmjetme para datës së tranzicionit.

C14B Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përdorë të njëjtë metodën sistematike dhe racionale që ajo pret të përdorë pas datës së tranzicionit kur zbaton paragrafin 28A për të shpërndarë çdo fluks monetar të blerjes së sigurimit të paguar (ose për të cilën është njohur një detyrim në zbatim të një SNRF tjetër) para datës së tranzicionit (duke përjashtuar çdo shumë të lidhur me kontratat e sigurimit që pushojnë së ekzistuari në datën e tranzicionit) tek:

(a) grupet e kontratave të sigurimit të njohura në datën e tranzicionit; dhe

(b) grupet e kontratave të sigurimit që pritet të njihen pas datës së tranzicionit.

C14C Flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara para datës së tranzicionit që shpërndahen tek një grup i kontratave të sigurimit të njohura në datën e tranzicionit rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit të atij grupi, në masën që kontratat e sigurimit të cilat pritet të jenë në grup njihen në atë datë (shih paragrafët 28C dhe B35C). Flukse të tjera monetare të blerjes së sigurimit të paguara para datës së tranzicionit, përfshirë ato të shpërndara tek një grup kontratash sigurimi që pritet të njihen pas datës së transaksionit, njihen si një aktiv duke zbatuar paragrafin 28B.

C14D Nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të zbatuar paragrafin C14B, ajo do të përcaktojë që shumat në vijim të jenë zero në datën e tranzicionit:

(a) rregullimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash të njohura në datën e tranzicionit dhe të çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit të lidhura me atë grup; dhe

(b) aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit për grupet e kontratave të sigurimit që pritet të njihen pas datës së tranzicionit.

C15 Nëse zbatimi i paragrafëve C12–C14D~~C14~~ rezulton në marzh të kontraktuar shërbimi në datën e njohjes fillestare, për të përcaktuar marzhin e kontraktuar të shërbimit në datën e tranzicionit njësia ekonomike do:

...

C16 Nëse zbatimi i paragrafëve C12–C14D~~C14~~ sjell një përbërës humbjeje nga detyrimi për mbulimin e mbetur në datën e njohjes fillestare, njësia ekonomike do të përcaktojë çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje para datës së tranzicionit, duke zbatuar paragrafët C12–C14D~~C14~~ dhe duke përdorur një bazë shpërndarjeje sistematike.

C16A Për një grup të kontratave të risigurimit të mbajtura që ofrojnë mbulim për një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit dhe që kishte hyrë në fuqi në të njëjtën kohë me emetimin e kontratave të sigurimit ose më parë, njësia ekonomike do të krijojë një përbërës rikuperim humbje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit (shih paragrafët 66A–66B). Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbje duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit bazë në datën e transaksionit (shih paragrafët C16 dhe C20); dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C16B Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e tranzicionit njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin C16A njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C16C Nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të zbatuar paragrafin C16A, njësia ekonomike nuk do ta identifikojë një përbërës rikuperim humbjeje për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtuara.

Përcaktimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit ose përbërësit humbje për grupet e kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

C17 Për sa lejohet nga paragrafi C8, për kontratat me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, njësia ekonomike në datën e tranzicionit duhet të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur si:

(a) total i vlerës së drejtë të zërave bazë në atë datë; minus

(b) flukset monetare të realizuara në atë datë; plus ose minus

(c) një rregullim për:

...

(iv) flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara (ose për të cilat është njohur një detyrim duke zbatuar një SNRF tjetër) para datës së tranzicionit që janë shpërndarë tek grupi (shih paragrafin C17A).

(d) nëse pikat (a)–(c) sjellin një marzh të kontraktuar shërbimi—minus shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit që lidhet me shërbimet e ofruara para asaj date. Totali sipas pikave (a)–(c) është një përafrues i marzhit total të kontraktuar të shërbimit për të gjitha shërbimet që do të ofrohen sipas grupit të kontratave, d.m.th para çdo shume që do të ishte njohur në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës) për shërbimet e ofruara. Njësia ekonomike do t'i vlerësojë shumat që do të ishin njohur në rezultat për shërbimet e ofruara, duke krahasuar njësitë për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit me njësitë e mbulimit të ofruara sipas grupit të kontratave para datës së tranzicionit; ose

(e) nëse pikat (a)–(c) sjellin një përbërës humbje—rregullon përbërësin humbje në zero dhe rrit detyrimin për mbulimin e mbetur, duke përjashtuar përbërësin humbje me të njëjtën shumë.

C17A Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët C14B–C14D për të njohur një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit si dhe çdo rregullim në marzhin e kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin C17(c)(iv)).

Është shtuar paragrafi C19A. Teksti i ri është i nënvizuar.

Të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit

...

C19A Duke zbatuar paragrafin B137, njësia ekomomike mund të zgjedhë të mos ndryshojë trajtimin e vlerësimit kontabël të bërë në pasqyrat financiare te ndërmjetme të mëparshme. Në masën e lejuar nga paragrafi C8, një njësi e tillë ekonomike do të përcaktojë shumat e lidhura me të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit në datën e tranzicionit sikur ajo të mos kishte përgatitur pasqyra financiare të ndërmjetme para datës së tranzicionit.

Janë shtuar paragrafët C20A–C20B dhe C22A, si dhe është ndryshuar paragrafi C21. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Modeli i vlerës së drejtë

...

C20A Për një grup kontratash risigurimi të mbajtura për të cilat zbatohen paragrafët 66A–66B (pa pasur nevojë të plotësojnë kushtet e paraqitura në paragrafin B119C), njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit bazë në datën e transaksionit (shih paragrafët C16 dhe C20); dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C20B Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e tranzicionit njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin C20A njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C21 Kur zbaton metodën e vlerës së drejtë, njësia ekonomike mund të zbatojë paragrafin C22 për të përcaktuar:

(a) ...

(b) nëse një kontratë sigurimi plotëson përkufizimin e kontratës së sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B101–B109; ~~dhe~~

(c) sesi të identifikojë flukset monetare të lira për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B98–B100; dhe~~.~~

(d) nëse një kontratë investimi plotëson përkufizimin e një kontrate investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17, duke zbatuar paragrafin 71.

...

C22A Kur zbaton metodën e vlerës së drejtë, njësia ekonomike mund të zgjedhë të klasifikojë si detyrim për kërkesat shtesë të pësuara një detyrim për shlyerjen e kërkesave shtesë të ndeshura para se një kontratë sigurimi të ishte blerë në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3.

...

Janë shtuar paragrafët C24A–C24B si dhe një titull mbi paragrafët C24A-C24B. Teksti i ri është i nënvizuar.

Aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit

C24A Kur zbatohet metoda e vlerës së drejtë për aktivin e flukseve monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin C5B(b)) në datën e tranzicionit, njësia ekonomike do të përcaktojë një aktiv për flukset monetare

të blerjes së sigurimit me një shumë të barabartë me flukset monetare të blerjes së sigurimit që njësia ekonomike do të ndeshë në datën e tranzicionit për të drejtat për të marrë:

(a) rikuperime të flukseve monetare të blerjes së sigurimit nga primet e kontratave të sigurimit të emetuara para datës së tranzicionit por ende të panjohura në datën e tranzicionit;

(b) kontrata të ardhshme të sigurimit që janë rinovime të kontratave të sigurimit të njohura në datën e transaksionit dhe kontratat e sigurimit të përshkruara në pikën (a); dhe

(c) kontrata të ardhshme sigurimi, të ndryshme nga ato në pikën (b), pas datës së transaksionit pa paguar përsëri flukset monetare të blerjes së sigurimit që blerësi ka paguar tashmë dhe që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek portofoli përkatës i kontratave të sigurimit.

C24B Në datën e tranzicionit, njësia ekonomike do të përjashtojë nga matja e çdo grupi kontratash sigurimi shumën e ndonjë aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit.

Është ndryshuar paragrafi C34. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Tërheqja e SNRF-ve të tjera

C34 SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 *Kontrata sigurimi*, të ndryshuar në vitin 2020~~2016~~.

Ndryshime në Shtojcën D—Ndryshime në SNRF-të e tjera

Kjo shtojcë paraqet ndryshimet në Standardet e tjera, pasojë e publikimit të SNRF 17 nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit *Kontratat e sigurimit* në qershor 2020. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

SNRF 3 *Kombinime Biznesi*

Në ndryshimet e SNRF 3 *Kombinime biznesi*, janë ndryshuar paragrafët 31A dhe 64N. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

...

Kontratat e sigurimit

31A Blerësi duhet të masë një grup kontratash brenda objektit të SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* të blera në një kombinim biznesi, dhe ndonjë aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit siç përcaktohet në SNRF 17 si një detyrim ose aktiv në përputhje me paragrafët 39 dhe B93–B95F~~B95~~ të SNRF 17, në datën e blerjes.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

64N SNRF 17, i publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafët 17, 20, 21, 35 dhe B63, si dhe shtoi një titull dhe paragrafin 31A pas paragrafit 31. *Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar paragrafin 31A. Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në paragrafin 17 tek kombinime biznesi me datë blerje pas datës së zbatimit për herë të parë të SNRF 17. Njësia ekonomike do t'i zbatojë ~~këto~~ ndryshimet e tjera kur zbaton SNRF 17.

SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*

Në ndryshimet e SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*, janë ndryshuar paragrafët 3 dhe 44DD. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qëllimi

3 Ky SNRF do të aplikohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiar, përveç:

...

(d) kontratave të sigurimit të përkufizuara në~~kontrata brenda objektit të~~ SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* ose kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17. Por, ky SNRF zbatohet për:

(i) derivativët e përfshirë në kontratat e sigurimit brenda objektit të SNRF 17, nëse SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike t'i trajtojë ato veçmas.~~; dhe~~

(ii) përbërësit investim që janë veçuar nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, nëse SNRF 17 kërkon një veçim të tillë, me përjashtim të rastit kur përbërësi investim i veçuar është një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë.

(iii) të drejtat dhe detyrimet e një emetuesi që vijnë nga kontratat e sigurimit që plotësojnë përkufizimin e~~Për më tepër, një emetues do të zbatojë këtë SNRF ndaj~~ *kontratave të garancisë financiare*, nëse emetuesi zbaton SNRF 9 në njohjen dhe matjen e kontratave. Megjithatë, emetuesi~~, por~~ do të zbatojë SNRF 17 nëse ai zgjedh, në përputhje me paragrafin 7(e) të SNRF 17, të zbatojë SNRF 17 për njohjen dhe matjen e kontratave~~tyre~~.

(iv) të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat për kartat e kreditit, ose kontrata të ngjashme që ofrojnë kreditim ose marrëveshje pagese, të emetuara nga njësia ekonomike, të cilat plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi nëse njësia ekonomike zbaton SNRF 9 ndaj atyre të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me paragrafin 7(h) të SNRF 17 dhe paragrafin 2.1(e)(iv) të SNRF 9.

(v) të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat e sigurimit të emetuara të njësisë ekonomike të cilat kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në një shumë që ndryshe do të kërkohej për të shlyer detyrimin e policë mbajtësit të krijuar nga kontrata, nëse njësia ekonomike zgjedh që për kontrata të tilla, në përputhje me paragrafin 8A të SNRF 17 të zbatojë SNRF 9 në vend të SNRF 17.

(e) ...

...

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

44DD SNRF 17, i publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafët 3, 8 dhe 29 dhe fshiu paragrafin 30. *Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 3. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*

Në ndryshimet e SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*, janë ndryshuar paragrafët 2.1 dhe 7.1.6. Janë shtuar një titull dhe paragrafët 7.2.36–7.2.42. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Kapitulli 2 Objekti

2.1 Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:

...

(e) të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga një kontratë sigurimi sipas përkufizimit në~~një kontratë brenda objektit të~~ SNRF 17 *Kontratat e sigurimit*, ~~, përveç të drejtave dhe detyrimeve të emetuesit që rrjedhin nga një kontratë sigurimi që plotëson përcaktimin si një kontratë garancie financiare~~, ose një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17. Megjithatë, ky Standard zbatohet për:

(i) derivativët~~një derivativ~~ që janë të~~është i~~ përfshirë në kontratat~~një kontratë~~ brenda objektit të SNRF 17, nëse derivativët nuk janë vetë kontrata~~derivativi nuk është vetë kontratë~~ brenda objektit të SNRF 17.~~; dhe~~

(ii) përbërësit investim~~një përbërës investim~~ që janë të~~është i~~ veçuar nga kontratat~~një kontratë~~ brenda objektit të SNRF 17, nëse SNRF 17 kërkon një veçim të tillë, me përjashtim të rastit kur përbërësi investim i veçuar është një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17.

(iii) të drejtat dhe detyrimet e emetuesit sipas kontratave të sigurimit që plotësojnë përkufizimin e një kontrate të garancisë financiare. Megjithatë~~Sidoqoftë~~, nëse emetuesi i kontratave të garancisë financiare ka pohuar më parë në mënyrë të qartë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, ai mund të zgjedhë të zbatojë ose këtë Standard ose SNRF 17 për kontrata të tilla të garancisë financiare (shih paragrafët B2.5–B2.6). Emetuesi mund ta bëjë zgjedhjen kontratë për kontratë, por zgjedhja për secilën kontratë është e pakthyeshme.

(iv) të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat për kartat e kreditit, ose kontrata të ngjashme që ofrojnë kreditim ose marrëveshje pagese, të emetuara nga njësia ekonomike, të cilat plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi por që paragrafi 7(h) i SNRF 17 i përjashton nga objekti i SNRF 17. Megjithatë vetëm dhe vetëm nëse mbulimi i sigurimit është një kusht i kontraktuar i një instrumeti të tillë financiar, njësia ekonomike do ta veçojë atë përbërës dhe do të zbatojë SNRF 17 ndaj tij (shih paragrafin 7(h) të SNRF 17).

(v) të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat e sigurimit të emetuara të njësisë ekonomike të cilat kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në një shumë që ndryshe do të kërkohej për të shlyer detyrimin e policë mbajtësit të krijuar nga kontrata, nëse njësia ekonomike zgjedh që për kontrata të tilla, në përputhje me paragrafin 8A të SNRF 17 të zbatojë SNRF 9 në vend të SNRF 17.

(f) ...

...

Kapitulli 7 Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

7.1 Data e hyrjes në fuqi

...

7.1.6 SNRF 17, i publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafët 2.1, B2.1, B2.4, B2.5 dhe B4.1.30 si dhe shtoi paragrafin 3.3.5. *Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 2.1.dhe ka shtuar paragrafët 7.2.36–7.2.42. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

...

7.2 Periudha kalimtare

...

Periudha kalimtare për SNRF 17 pas ndryshimeve të qershorit 2020

7.2.36 Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në SNRF 9 si pasojë e SNRF 17 të ndryshuar në qershor 2020 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, me përjashtim të sa specifikohet në paragrafët 7.2.37–7.2.42.

7.2.37 Njësia ekonomike që zbaton për herë të parë SNRF 17 me ndryshimet e qershorit 2020 dhe njëkohësisht këtë Standard për herë të parë, do të zbatojë paragrafët 7.2.1–7.2.28 në vend të paragrafëve 7.2.38–7.2.42.

7.2.38 Njësia ekonomike që zbaton SNRF 17 me ndryshimet e qershorit 2020 për herë të parë pasi ka zbatuar për herë të parë këtë Standard do të zbatojë paragrafët 7.2.39–7.2.42. Gjithashtu njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat e tjera të periudhës kalimtare në këtë Standard të nevojshme për zbatimin e këtyre ndryshimeve. Për këtë qëllim, referencat për datën e aplikimit fillestar do të lexohen duke i'u referuar fillimit të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime (data e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve).

7.2.39 Në lidhje me përcaktimin e një detyrimi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, njësia ekonomike:

(a) do të anulojë përcaktimin e saj të mëparshëm të detyrimit financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë është bërë në përputhje me kushtin në paragrafin 4.2.2(a) por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve ky kusht nuk përmbushet më; dhe

(b) mund të përcaktojë një detyrim financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim më parë nuk ka përmbushur kushtin në paragrafin 4.2.2(a) por si rezultat i aplikimit të këtyre ndryshimeve, ky kusht përmbushet tani .

Një përcaktim dhe anulim i tillë, do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.40 Njësia ekonomike nuk është e detyruar të riparaqesë periudhat e mëparshme për të reflektuar zbatimin e këtyre ndryshimeve. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e hamendësimeve. Nëse njësia ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të riparaqitura duhet të pasqyrojnë të gjitha kërkesat e këtij Standardi për instrumentet financiare të prekura. Nëse njësia ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, ajo duhet të njohë çdo diferencë midis vlerës kontabël (neto) të mëparshme dhe vlerës kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, në fitimet e pashpërndara në çelje (ose një përbërës tjetër më të përshtatshëm të kapitalit neto) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve.

7.2.41 Në periudhën e raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë të këtyre ndryshimeve, nuk kërkohet që njësia ekonomike të paraqesë informacionet sasiore të kërkuara nga paragrafi 28(f) i SNK 8.

7.2.42 Në periudhën raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve, njësia ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm në atë datë për secilën klasë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që janë prekur nga këto ndryshime:

(a) klasifikimin e mëparshëm, duke përfshirë kategorinë e mëparshme të matjes dhe kur është e mundur, vlerën kontabël (neto) të përcaktuar menjëherë para zbatimit të këtyre ndryshimeve;

(b) kategorinë e re të matjes dhe vlerën kontabël (neto) të përcaktuar në përputhje me këto ndryshime;

(c) vlerën kontabël (neto) të çdo detyrimi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar që më parë ishin përcaktuar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, por që nuk përcaktohen më si të tillë; dhe

(d) arsyet për çdo përcaktim ose jo të detyrimeve financiare si të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*

Në ndryshimet e SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare* janë ndryshuar paragrafët 54 dhe 139R. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Informacioni për t'u paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar

54 **Pasqyra e pozicionit financiar duhet të përfshijë minimalisht zërat që paraqesin shumat vijuese:**

...

(da) **portofoletgrupet e kontratave brenda objektit të SNRF 17 që janë aktive, të zbërthyera siç kërkohet nga paragrafi 78 i SNRF 17;**

...

(ma) **portofoletgrupet e kontratave brenda objektit të SNRF 17 që janë detyrime, të zbërthyera siç kërkohet nga paragrafi 78 i SNRF 17;**

...

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

139R SNRF 17, i publikuar në maj të vitit 2017, ka ndryshuar paragrafët 7, 54 dhe 82. *Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 54. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

...

SNK 32 *Instrumentet Financiare: Paraqitja*

Në ndryshimet e SNK 32 *Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*, janë ndryshuar paragrafët 4 dhe 97T. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qëllimi

4 **Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:**

...

(d) **kontratat e sigurimit të përkufizuara nëkontrata brenda objektit të SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* ose kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17. Megjithatë, ky Standard zbatohet për:**

(i) **derivativët e përfshirë në kontratat e sigurimit brenda objektit të SNRF 17, nëse SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike t'i trajtojë ata veçmas.; dhe**

(ii) **përbërësit investim që janë veçuar nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, nëse SNRF 17 kërkon një veçim të tillë, me përjashtim të rastit kur përbërësi investim i veçuar është një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17.**

(iii) **të drejtat dhe detyrimet e një emetuesi që vijnë nga kontratat e sigurimit që plotësojnë përkufizimin ePër më tepër, një emetues do të zbatojë këtë SNRF ndaj kontratave të garancisë financiare, nëse emetuesi zbaton SNRF 9 në njohjen dhe matjen e kontratave. Megjithatë, emetuesi, por do të zbatojë SNRF 17 nëse ai zgjedh, në përputhje me paragrafin 7(e) të SNRF 17, të zbatojë SNRF 17 për njohjen dhe matjen e kontratavetyre.**

(iv) **<u>të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat për kartat e kreditit, ose kontrata të ngjashme që ofrojnë kreditim ose marrëveshje pagese, të emetuara nga njësia ekonomike, të cilat plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi nëse njësia ekonomike zbaton SNRF 9 ndaj atyre të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me paragrafin 7(h) të SNRF 17 dhe paragrafin 2.1(e)(iv) të SNRF 9.</u>**

(v) **<u>të drejtat dhe detyrimet e njësisë ekonomike që janë instrumente financiarë që vijnë nga kontratat e sigurimit të emetuara të njësisë ekonomike të cilat kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në një shumë që ndryshe do të kërkohej për të shlyer detyrimin e policë mbajtësit të krijuar nga kontrata, nëse njësia ekonomike zgjedh që për kontrata të tilla, në përputhje me paragrafin 8A të SNRF 17 të zbatojë SNRF 9 në vend të SNRF 17.</u>**

...

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

97T SNRF 17, i publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafët 4, UZ8 dhe UZ36 si dhe shtoi paragrafin 33A. <u>*Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 4.</u> Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*

Në ndryshimet e SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* janë ndryshuar paragrafët 2 dhe 140N. Teksti i ri është i nënvizuar.

Objekti

2 **Ky Standard do të zbatohet në kontabilizimin e zhvlerësimit të të gjithë aktiveve, me përjashtim të:**

...

(h) **kontratave brenda objektit të SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* që janë aktive <u>dhe ndonjë aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit siç përcaktohet në SNRF 17</u>; dhe**

...

Dispozita kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

140N SNRF 17, e publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafin 2. <u>*Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 2.</u> Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

SNK 38 *Aktivet Jo-materiale*

Në ndryshimet e SNK 38 *Aktivet jo-materiale* janë ndryshuar paragrafët 3 dhe 130M. Teksti i ri është i nënvizuar.

Objekti

...

3 Nëse një Standard tjetër përshkruan kontabilizimin për një lloj të veçantë të aktivit jo-material, njësia ekonomike zbaton atë Standard në vend të këtij Standardi. Për shembull, ky Standard nuk zbatohet për:

...

(g) kontratat brenda objektit të SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* dhe ndonjë aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit siç përcaktohet në SNRF 17.

(h) ...

...

Dispozita kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

130M SNRF 17, i publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafin 3. *Ndryshimet në SNRF 17*, i publikuar në qershor 2020, ka ndryshuar më tej paragrafin 3. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

URDHËR
Nr. 615, datë 9.11.2020

PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, *FAST FOOD* DHE LOKALEVE

Në zbatimi të nenit 7, pika 4, germa "b", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga *Coronavirus* i ri nr. 5005, datë 9.11.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, *fast food*, lokaleve, që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, deri në datën 2.12.2020.

2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë *(delivery)*, i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 616, datë 9.11.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germat "d", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga *Coronavirus* i ri nr. 5005, datë 9.11.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, deri në datën 2.12.2020.

2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëhet për personat që duhet të lëvizin për emergjenca shëndetësore, motive pune

apo nevoja të domosdoshme. Personat që lëvizin për arsye pune apo arsye të domosdoshme pajisen me autorizimin përmes portalit *e-Albania*.

3. Personeli i shëndetësisë, punonjësit e strukturave të shërbimeve kritike, përjashtohen nga rregulli i aplikimit në portalin *e-Albania*, duke pasur dokumentacionin që vërteton punësimin pranë institucioneve.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

AUTORIZIM
Nr. 7949, datë 3.11.2020

Në mbështetje të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2020, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; vendimit nr. 525, datë 8.8.2007, "Për identifikimin e koncesionit për projektin 'Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike'"; "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 13.4.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e projektit 'Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë" dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Brendshme" dhe kontratës koncesionare, datë 21 korrik 2008, "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike", të ndryshuar,

AUTORIZOJ:

Znj. Elena Pici, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, të nënshkruajë në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Brendshme, Marrëveshjen "Për hapjen dhe funksionimin e zyrave në ambasada", me konsorciumin e shoqërive Idemia Identity & Security SA (*Sagem Securite*) dhe Fondit Shqiptaro–Amerikan të Ndërmarrjeve, të përfaqësuara nga shoqëria "Aleat" sh.p.k.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

VENDIM
Nr. 99, datë 16.10.2020

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA 'TË GJELBËRTA', TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKOMIQËSOR OSE BIZNESE EKZISTUESE, TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË BIZNESE 'TË GJELBËRTA', DUKE FUTUR ELEMENTE *GO-GREEN* NË TO"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Anila Denaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Etleva Haka	anëtare;
Znj. Mirjana Zisi	anëtare.
Z. Ahmet Mançellari	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 16.10.2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", morri në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 26214, datë 5.8.2020, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 157, datë 26.12.2019, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020" në

programin 04130 "Mbështetje për zhvillimin ekonomik".

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i ndihmës ka si objektiv mbështetjen e sipërmarrjeve të rinj që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta dhe ndërmarrjet ekzistuese që aplikojnë parimet e ekonomisë së gjelbërt në prodhim produktesh dhe konsum lëndësh të para.

3. Baza ligjore e njoftimit të planit: Plani i ndihmës shtetërore është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 157, datë 26.12.2019, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020" në programin 04130 "Mbështetje për zhvillimin ekonomik".

4. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2020–2022.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: Përfitues: sipërmarrësit e rinj që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta dhe ndërmarrjet ekzistuese, që aplikojnë parimet e ekonomisë së gjelbërt në prodhimin produktesh dhe konsum lëndësh të para.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. Forma, vlera dhe intensiteti i ndihmës: Vlera e përgjithshme e fondit, për periudhën 2020–2022 do të jetë 36 000 000 lekë. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 12 000 000 lekë. Çdo përfitues do të mbështetet me grant të drejtpërdrejtë në shumën 500,000 lekë (pesëqind mijë lekë). Intensiteti i ndihmës do të jetë 80% të kostove të pranueshme.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse njoftimi i skemës për mbështetjen e sipërmarrjeve të rinj, që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta dhe ndërmarrjeve ekzistuese që aplikojnë parimet e ekonomisë së gjelbërt në prodhimin produktesh dhe konsum lëndësh të para, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, përbën një skemë të ndihmës shtetërore.

10. Neni 4, pika 1, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.".

11. Gjithashtu, neni 71, "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropianë e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1] përcakton se:

"Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.".

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Bashkia e Tiranës ka njoftuar planin e ndihmës shtetërore, i cili lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e grantit, me qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve të reja dhe ato ekzistuese të vogla dhe të mesme në territorin e bashkisë. Plani i ndihmës së njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se përmirëson situatën ekonomike të disa ndërmarrjeve në treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar, në përputhje me nenin 11 "Ndihma për investime", të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare'".

kategorive të ndihmës shtetërore"', pasi skema e njoftuar e ndihmës shtetërore përmbush si më poshtë:

- Mbulon kostot e pranueshme si vijon:

a) kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme;

b) kostot e parashikuara të pagave, në lidhje me punësimin e krijuar drejtpërsëdrejti nga projekti i investimit, të përllogaritura gjatë një periudhe dyvjeçare.

- Investimi do të konsiderohet si kosto e pranueshme, pra në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje me produkte të reja shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese.

- Vendet e punës të jenë të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit.

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, vlerëson se skema mbështetëse me grant për ndërmarrjeve të reja dhe ato ekzistuese të vogla dhe të mesme në territorin e Bashkisë Tiranë, përfshihet në rastet e parashikuara ndryshe në këtë ligj dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës të nenit 8/1, "Ndihma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe shkronjës "c", të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, e cila lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8/1, 13, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe të nenin 12, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore"',

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për "Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbërta', të cilat bazohen në një model ekomiqësor ose biznese ekzistuese, të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbërta', duke futur elementë *go-green* në to".

2. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

3. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 4, datë 23.10.2020

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror"', i ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror"'; KDZH-ja, e ngritur me urdhrin nr. 389, datë 20.11.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mblodh më datë 23.10.2020, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve, (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

- F. 308/AP (Fondi i Solidaritetit)

Viti 1965, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1966, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1967, dosja 1. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1968, dosja 1. Niveli i klasifikimit "Sekret".

Viti 1969, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1970, dosja 1. Niveli i klasifikimit "Sekret".

Viti 1971, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1973, dosjet 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1974, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1976, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1977, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1978, dosja 1, 3. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1979, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1980, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1981, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1982, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1983, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1984, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1985, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1986, dosja 1, 2. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1986, dosja 2. Niveli i klasifikimit "Sekret".

Viti 1987, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1988, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1989, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Viti 1990, dosja 1. Niveli i klasifikimit "T. Sekret".

Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika "b", të VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017.

2. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

3. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ardit Bido

VENDIM
Nr. 163, datë 22.10.2020

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË OST SHA PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 1, të nenit 19, germa "c", pika "i", nenit 21 dhe nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017 dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "c", dhe pika 3 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/11 prot., datë 15.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 5686 prot., datë 24.9.2020 (protokolluar në ERE me nr. 1118 prot., datë 25.9.2020), ka paraqitur aplikimin për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

- Për sa i përket llogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2021, shoqëria OST sh.a. ka paraqitur, sipas tabelës, llogaritjet përkatëse dhe ka kërkuar një shtesë prej 0.056 lekë/KWh nga tarifa e miratuar për vitin 2020, duke e çuar tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021 në vlerën 1.31 lekë/KWh nga 0.75 lekë/KWh që është aktualisht.

Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE", rezulton se OST-ja për qëllime të këtij aplikimi ka paraqitur pjesërisht si vijon:

- Në pikën 1 dhe 2, të nenit 21, parashikohet, ndër të tjera, se i licencuari duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores dhe metodologjive përkatëse; plotësuar pjesërisht.

- Në pikën 1, të nenit 22, përcaktohet se aplikimi shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1.1 Një deklaratë që përshkruan qëllimin dhe efektin e propozimit te paraqitur;

- 1.2 Efektet e pritshme në të ardhurat e shoqërisë nga tarifat apo çmimet e propozuara;

- 1.4 (d) Tarifat/çmimet e aplikuara nga aplikuesi ndaj klientëve të tij për çdo shërbim të energjisë elektrike dhe/apo te gazit natyror, duke përfshirë çdo informacion tjetër të nevojshëm për të argumentuar ndryshimet në tarifat/çmimet e kërkuara nga aplikuesi.

- OST-ja nuk ka dhënë shpjegime, në lidhje me ndryshimet e propozuara në tarifën e transmetimit, i cili është shërbimi i vetëm që ofron ky operator.

- OST sh.a. ka paraqitur vetëm një informacion të përgjithshëm rreth aktivitetit të saj, duke listuar përgjegjësitë kryesore të saj, të cilat burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, duke cilësuar dhe kostot që tarifa e transmetimit synon të shlyejë.

- Rritja e propozuar sipas OST sh.a., e cila është paraqitur pa informacione dhe dokumentacion, por vetëm në formë narrative, është vlerësuar si rrjedhojë e pagesave të kredive që Shoqëria pret të ketë, investimeve të pritshme, të cilat pret të mbulojë me fondet e veta, si dhe rritjes së shpenzimeve që OST-ja pret të ketë për vitin 2021, lidhur me shërbimet ndihmëse me hyrjen në fuqi të "Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", sipas vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, të Bordit të ERE-s, të propozuara nga vetë OST sh.a.

- Në pikën 2, të nenit 22, përcaktohet se, propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë: një deklaratë të vitit të testimit, një raport vjetor për vitin e testimit, shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet e aplikuara gjatë vitit të testimit, si dhe rregullimet e propozuara që lidhen me shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat/çmimet për vitin e testimit.

- Konstatohet se OST sh.a. nuk ka paraqitur një raporti mbi shpenzimet, të ardhurat dhe tarifat e aplikuara dhe realizuara, si dhe efektet e tyre në pritshmërinë për vitin 2020, ku nga sa rezulton në aplikim është viti 2019, i cili tashmë është i mbyllur dhe OST sh.a. disponon të dhënat mbi realizimin e çdo treguesi financiar, teknik dhe ekonomik. Ndërkohë, në aplikim janë paraqitur të dhënat për vitin 2019 dhe 2020 të miksuara, duke mos bërë të qartë efektet e realizimit të secilit komponent të përllogaritjes së tarifës gjatë vitit 2019, krahasuar me miratimin e tyre nga ERE, po për të njëjtën periudhë, efektet e realizimit të tarifës për vitin 2019, të cilat duhet të axhustohen në realizimin e treguesve financiarë për vitin 2020, si dhe realizimin e këtyre komponentëve për periudhën janar–shtator, të shoqëruar me pritshmërinë e shoqërisë deri në përfundim të vitit 2020.

- Në pikën 3, të nenit 22, përcaktohet se propozimet për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, një përshkrim të çdo ndryshimi që lidhet me përbërjen e tarifave dhe çmimeve, duke përfshirë arsyet për këto ndryshime, efektet e ndryshimeve të propozuara ndaj klasave/grupeve të ndryshme të klientëve, ndaj shërbimeve të tjera që sigurohen nga aplikuesi apo shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë, si dhe ndryshimet në faturat përkatëse çdo klasë/grup të klientëve.

- Shoqëria nuk ka paraqitur asnjë informacion lidhur me efektet e tarifës së propozuar kundrejt tarifës aktuale dhe impakti i saj në veprimtarinë e shoqërive të tjera që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike.

- OST sh.a. nuk ka dokumentuar parashikimet lidhur me kërkesën për energji për vitin 2021 të shoqërive KESH sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. apo dhe FTL sh.a., si dhe sasive që parashikojnë të livrojnë në rrjetin e transmetimit, për vitin 2021 konsumatorët e mëdhenj të lidhur në Rrjetin e Transmetimit apo dhe të shpërndarjes.

- Në pikën 4, të nenit 22, përcaktohet se në qoftë se aplikuesi pretendon se ndonjë nga informacionet e kërkuara sipas këtij neni apo metodologjive përkatëse, nuk është i mundshëm, ai duhet të paraqesë arsyet e pretendimit. Paaftësia për të dhënë arsye të përshtatshme për mos

paraqitjen e ndonjë informacioni shkakton trajtimin e propozimit si një propozim të parregullt.

- OST sh.a. në aplikim nuk ka shprehur asnjë deklarim e aq më tepër asnjë arsyetim të tillë.

Në zbatim të përcaktimeve të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", rezulton se OST-ja, për qëllime të këtij aplikimi, ka paraqitur pjesërisht si vijon:

- në pikën 3, të nenit 5, përcaktohet, ndër të tjera, se pagesat e lidhjes me sistemin e transmetimit për përdoruesit e sistemit të transmetimit nuk janë objekt i kësaj metodologjie;

- nga aplikimi nuk rezulton të ketë një ndarje mes të ardhurave të realizuara dhe të pritshme, të pagesave të lidhjes me sistemin e transmetimit me të ardhurat e kërkuara;

- në pikën 7 dhe në pikën 8, të nenit 5, përcaktohet mes të tjerave se: kohëzgjatja e ciklit të shqyrtimit të tarifave të transmetimit është tre vjet;

- konstatohet se shoqëria vijon të aplikojë për tarifë, për një periudhë njëvjeçare, ndryshe nga sa parashikuar më sipër;

- në pikën 10, të nenit 5, përcaktohet se financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit;

- mungesa e një informacioni të detajuar në aplikim mbi kreditë e marra nga OST sh.a., nuk lejon vlerësimin dhe analizimin lidhur me destinacionin e përdorimit të këtyre fondeve;

- në pikën 11 dhe pikën 14, të nenit 5, përcaktohet se: i) aplikimi krahas informacionit dhe dokumentacionit argumentues të nevojshëm për llogaritjen e tarifës mesatare tavan të shërbimeve të rregulluara të transmetimit duhet të përmbajë dhe një informacion të plotë mbi treguesit teknikë, ekonomikë dhe financiarë, si dhe llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë shoqërinë; dhe ii) kostot e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për palët e interesuara;

- rezulton se në aplikim janë paraqitur vetëm deklarime në formë narrative të pashoqëruara me informacione dhe dokumentacion të nevojshëm, siç janë kërkuar edhe më lart, çka nuk përmbush kushtet sa më sipër;

- në pikën 15, të nenit 5, përcaktohet se tarifa duhet t'i lejojë OST-së mundësinë e një kthimi të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të aseteve;

- rezulton se, OST-ja nuk ka paraqitur komponentët e llogaritjes së kthimit të lejuar mbi (RAB);

- në pikën 18, të nenit 5, përcaktohet, ndër të tjera, se në përgatitjen e aplikimit për tarifa OST-ja do të përpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë;

- konstatohen vetëm deklarime dhe tabela me shifra sintetike, të cilat janë paraqitur të pashoqëruar me dokumente dhe analiza jo vetëm për realizimin e tyre dhe pritshmërinë për vitin 2020 apo planifikimin e shoqërisë për kryerjen e këtyre shpenzimeve për vitin 2021. Në mënyrë që të konstatohen kostot me saktësi, por dhe tregues të tjerë financiarë, lidhur me aktivitetin e OST sh.a., duhet të ishin përcjellë llogaritë e shoqërisë sipas "Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018;

- në pikën 4, të nenit 6, përcaktohet, se energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së me tension të ulët ose mesatar dhe të livruar nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes, duhet përfshirë në shumën totale të energjisë së livruar në rrjetin e shpërndarjes;

- në aplikim nuk paraqiten të dhëna apo argumente nëse energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së në nivelet respektive të tensionit si më lart dhe nuk është përfshirë në humbjet totale të sistemit të transmetimit të parashikuara për vitin 2021.

- Në pikën 3, të nenit 7, përcaktohet se, OST-ja duhet të paraqesë justifikime për çdo rregullim/korrigjim të parashikuar të rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OST-ja në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim, duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi;

- Rezulton e papërmbushur kjo kërkesë e metodologjisë. Në përmbledhjen tabelore, të paraqitur në këtë aplikim, të dhënat financiare, të realizuara për vitin 2019 dhe që priten të realizohen për vitin 2020, janë paraqitur të miksuara, duke mos reflektuar rregullimin/korrigjimin e realizimit të treguesve financiarë dhe asnjë informacion apo dokumentacion vërtetues (provë) për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi;

- pika 4 (4.2.4), e nenit 7, përcakton se, amortizimi i kategorive të ndryshme të aseteve do të bazohet mbi jetën operuese të pritshme të këtyre aseteve. Nëse të dhënat financiare janë shtrembëruar nga përdorimi i shifrave shumë të larta për jetëgjatësinë e amortizimit, atëherë OST-ja paraqet një studim për amortizimin e asteve, i cili duhet të tregojë jetën e aseteve për çdo kategori;

- OST-ja nuk ka dhënë shpjegime për jetën operuese të aseteve për vitin 2019 dhe pritshmërinë për vitin 2020;

- në zbatim të pikës 5, nenit 60, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të paraqesë pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës edhe planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës, detyrim, i cili nuk është përmbushur nga ana e OST sh.a.;

- në nenin 8 përcaktohet ndarja e kostove për kapacitet, energji dhe pagesa fikse mujore;

- rezulton se në këtë aplikim janë paraqitur disa tabela, të cilat evidentojnë llogaritjen e totalit të kapaciteteve të përdoruesve, por pa deklaruar se sa është kapaciteti i vënë në dispozicion dhe sa për qind zë nga ai i përdorur;

- në pikën 3, të nenit 19, të rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, parashikohet se: Bordi merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit nëse konstaton se aplikimi plotëson kryesisht kërkesat sipas rregulloreve përkatëse;

- rezulton se aplikimi i OST sh.a., përgjithësisht, nuk përmbush kërkesat dhe përcaktimet e: i) ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; ii) "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s"; iii) "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike"; iv) "Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike";

- aplikimi i shoqërisë OST sh.a. nuk plotëson kriteret formale dhe të përmbajtjes, si dhe ka kryesisht mangësi në dhënien e shpjegimeve mbi aspekte të veçanta të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021 prej 1.31 lekë/KWh.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 164, datë 22.10.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "RREGULLAVE PËR MONITORIMIN E TREGUT TË GAZIT NATYROR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/1 prot., datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror",

konstatoi se:

- Draftrregullat për monitorimin e tregut të gazit natyror u hartuan si dokument bazuar në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe përcaktojnë mënyrën dhe procedurat për monitorimin e funksionimit të tregut të gazit natyror, si dhe veprimtari të caktuara të operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes

për funksionimin e tregut të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

- Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të tregut të gazit natyror realizohet nga Enti Rregullator i Energjisë dhe ka për qëllim rritjen e eficiencës, konkurrencës dhe transparencës së tregut të gazit natyror, si dhe identifikimin e parregullsive.

- Monitorimi i funksionimit të tregut të gazit natyror ka të bëjë me mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe të informacionit, si dhe publikimin e informacionit sipas nenit 3, të këtyre draftrregullave.

- Të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror (tregtarët, furnizuesit, furnizuesit e mundësisë së fundit, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi të licencuarit në depozitim apo operim GNL, duhet të informojnë periodikisht në lidhje me numrin e klientëve, si dhe kategorizimin e tyre sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

- Kjo draftrregullore parashikon detyrimet e të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për të përcjellë në ERE të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me cilësinë e sigurimit të shërbimeve tregtare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror" në Shqipëri.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 165, datë 22.10.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "KODIT TË MATJES SË GAZIT NATYROR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 39, nenit 104, pika 1, nenit 116, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/2 prot., datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të matjes së gazit natyror",

konstatoi se:

- Referuar nenit 104, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, ERE miraton "Kodin e matjes" për sistemet e matjes dhe matjen e gazit natyror, të hartuar nga operatorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

- ERE, në mënyrë të përsëritur, i është drejtuar Operatorit të Kombinuar të Sistemit të Transmetimit, shoqërisë Albgaz sh.a., me kërkesën për draftimin e këtij dokumenti, por në mungesë të një dokumenti të draftuar dhe propozuar nga Operatori, si edhe për shkak të tejkalimit të afatit përcaktuar në nenin 116, pika 4, të ligjit për gazin, ERE draftoi këtë dokument.

- "Kodi i matjes" është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e gazit natyror.

- "Kodi i matjes" përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së gazit natyror, që do të jetë i përshtatshëm për matjen, mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut dhe marrëveshjeve midis palëve.

- Draftkodi i matjes së gazit natyror u hartua si dokument në zbatim të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe si pjesë e veçantë nga "Kodi i transmetimit të gazit" në Shqipëri.

- Drafti i kodit të matjes do të konsultohet me të licencuarit në sektorin e gazit natyror, si dhe me të gjithë palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të matjes së gazit natyror".

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 166, datë 22.10.2020

MBI MIRATIMIN E "KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË, QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI PUBLIK I FURNIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pikat 33 dhe 44, nenit 93, pika 1, dhe nenit 92, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/5 prot., datë 19.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë, që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 145, datë 28.8.2020, filloi procedurën për miratimin e draftit për kushtet e përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë, që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 1094 prot., datë 9.9.2020, janë njoftuar për fillimin e procedurës Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Albpetrol sh.a., Albgaz sh.a., Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqata e Konsumatorit në Fokus, Komisioneri për të Drejtën e Informimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë Elektrike.

- Me shkresën nr. 6418/1 prot., datë 17.9.2020, protokolluar në ERE me nr. 1094/1 prot., datë 18.9.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet parimisht dakord për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 1068/1 prot., datë 12.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 1094/2 prot., datë 14.10.2020, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kërkuar që në kontratën tip të adresohen dy kërkesa që burojnë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin sa më efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale. Kërkesat janë reflektuar në kontratën tip dhe specifikisht në pikën 4.3 të nenit 4.

- Ky dokument ka për qëllim mbrojtjen e palëve në ofrimin e shërbimit të furnizimit me gazin natyror si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë dhe objekti i tij është furnizimi me gaz natyror nga ana e furnizuesit të licencuar i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit dhe detyrimi i klientit për të paguar gazin natyror të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuar në të.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë, që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit" (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KUSHTET E PËRGJITHSHME
TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË, QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI PUBLIK I FURNIZIMIT

Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 22.10.2020.

Kontratë nr.

PJESA E PARË

E lidhur sot me datë _____, në _____.

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi i shërbimit publik _____, i regjistruar si person juridik, sipas legjislacionit në fuqi, sipas vendimit nr. _____, datë _____të QKR-së, pajisur me numër identifikimi pranë organeve tatimore _____dhe me licencën për furnizimin me gaz natyror dhe i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. _____, datë _____, në adresën zyrtare: _____, Shqipëri, përfaqësuar nga personi i autorizuar z./znj._____, identifikuar këtu e më poshtë si "furnizuesi",

dhe

Klienti fundor që përfiton nga shërbimi publik i furnizimit _____, përfaqësuar _____ (emri, atësia, dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të klientit), në adresën: rruga _____, ndërtesa _____, ap._____, Njësia Administrative nr._____, qytet/fshat _____, tel. nr. _____, identifikuar nga dokumenti i identifikimit të tij: nr. i pasaportës/kartë identiteti.

Pika e lidhjes në rrjetin e gazit natyror.....

Adresa e Klientit fundor për shërbimin e dërgimit të faturës.....

Nr. i tel..... adresa e *email* (nëse ka)……..…….....

Palët bien dakord që pjesa e dytë "Termat dhe kushtet" është pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

FURNIZUESI **KLIENTI**

_____

PJESA E DYTË
TERMAT DHE KUSHTET

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate konsiston në ofrimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në mbështetje të neneve 75, 89, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, gjithashtu dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Neni 3
Objekti i kontratës

3.1 Objekti i kësaj kontrate është furnizimi me gaz natyror nga ana e furnizuesit të licencuar i

ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit dhe detyrimi i klientit për të paguar gazin natyror të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.

3.2 Furnizimi me gaz natyror i klientëve fundorë nga furnizuesi i licencuar në pikën e lidhjes së sistemit e kërkuar nga klienti fundor me këto parametra teknikë:

- me sasia e kërkuar m³/kwh;
- me presion bar;
- cilësia sipas raportit të prodhuesit.

Neni 4
Dispozita të përgjithshme

4.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët, që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit me gaz natyror. Klienti nuk mund t'i japë apo të shesë gaz natyror klientëve të tjerë nga pika e tij e lidhjes.

4.2 Furnizuesi është i detyruar të mbrojë dhe të mos nxjerrë të dhënat personale të klientit, konform ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. Të dhënat personale të Klientit mund të jepen nga furnizuesi në rastet e mëposhtme:

- me pëlqimin e Klientit;
- në rast të respektimit të detyrimeve kontraktuale të furnizuesit, në lidhje me përmbushjen e shërbimit të shpërndarjes së faturave të gazit natyror dhe/ose arkëtimin e detyrimeve.
- Në zbatim të legjislacionit në fuqi.

4.3 Furnizuesi është i detyruar, që, kur mbledh të dhëna personale, për qëllim të kësaj kontrate, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave bazuar në nenin 18, të ligjit nr. 9887/2008 dhe, furnizuesi është përgjegjës në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej, referuar germës "d", të pikës 1, të nenit 5, të po këtij ligji.

Neni 5
Lidhja e kontratës

5.1 Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me gaz natyror çdo person jodebitor ndaj furnizuesit, që ka një pikë lidhjeje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të gazit natyror dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin e sektorit të gazit natyror.

5.2 Të drejtën e furnizimit nga furnizuesi i shërbimit publik e ka edhe çdo klient, i cili ka përfituar statusin e "klientit në nevojë" , sipas përcaktimeve të nenit 97, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe që është regjistruar pranë operatorit si i tillë.

5.3 Klienti fundor, që kërkon lidhjen e kontratës me furnizuesin e ngarkuar me shërbimin publik të furnizimit duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të furnizuesit, nga i cili merr shërbimin e furnizimit, shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në këtë kontratë.

5.4 Furnizuesi, pasi ka kontrolluar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën me klientin, brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së aplikuesit.

5.5 Nëse kërkesa e aplikuesit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, furnizuesi, brenda 7 ditësh kalendarike, do të njoftojë me shkrim, aplikuesin për mangësitë e konstatuara. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 7 ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do të refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë, me shkrim aplikuesin, në adresën e përcaktuar nga aplikuesi në kërkesën për furnizim, në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

5.6 Për një objekt, i cili është furnizuar me parë me gaz natyror, furnizuesi do të sigurojë lidhjen e kontratës së re, brenda 7 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar.

Neni 6
Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

6.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

6.1.1 Me kërkesë të klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 6.2.

6.1.2 Me iniciativën e furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e klientit të detyrimeve/kushteve thelbësore të kontratës, për të cilat njoftohet me

parë me shkrim. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e klientit rastet, si më poshtë:

a) nëse klienti nuk paguan detyrimet e gazit natyror, duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së gazit natyror;

b) nëse provohet nga furnizuesi që klienti merr gaz natyror në mënyrë të paligjshme;

c) nëse klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësve dhe të instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës të tij;

d) nëse klienti dhe pasi ka marrë njoftim me shkrim nga furnizuesi në afatet e parashikuara në ligj, për ndryshimin e kushteve të kontratës, të miratuara nga ERE, nuk merr masa për zbatimin e tyre.

6.1.3 Furnizimi me gaz natyror i klientëve, që kanë përfituar statusin e "klientëve në nevojë", do të ndërpritet vetëm sipas kushteve të parashikuara në rregulloren e miratuar nga ERE, sipas nenit 97, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

6.2 Nëse klienti kërkon të pezullojë/mbyllë kontratën e furnizimit me gaz natyror, ai do të njoftojë me shkrim furnizuesin 15 ditë kalendarike përpara, dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet përkundrejt furnizuesit jo më vonë se 30 ditë nga mbyllja apo pezullimi i kontratës. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtimit nëse aplikohet nga furnizuesi). Klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim që mund të rezultojë ndaj furnizuesit pas përfundimit të afatit 30-ditor pas depozitimit të kërkesës (kohë në të cilën janë shlyer të gjitha detyrimeve financiare).

6.3 Klienti mund të bëjë kërkesë për riaktivizimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror, pranë çdo përfaqësie të furnizuesit, i cili do të garantojë furnizimin me gaz natyror brenda 48 orëve, nga momenti i depozitimit të kërkesës.

6.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror, furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e gazit natyror në pikën e lidhjes, nëpërmjet operatorit të shpërndarjes. Me ndërprerjen e lidhjes, furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vuloset pika e lidhjes, duke u përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.5 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e gazit natyror deri në momentin e përfundimit të kontratës. Në çdo rast, klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 5.2.

Neni 7
Detyrimet e furnizuesit

7.1 Furnizuesi, në zbatim të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ka detyrimin të furnizojë klientët me gaz natyror, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

7.2 Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara në kontratë, informon klientët, në faturat përkatëse, për:

a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të gazit natyror;

b) konsumin dhe kostot aktuale të gazit natyror, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të gazit nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

d) procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të ankesave mes furnizuesit dhe klientit.

f) të bëj publike, duke reklamuar në zyrat e përfaqësive të tij dhe faqen e internetit procedurat për pezullimin dhe ndërprerjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror.

e) të njoftojë me shkrim klientin fundor, në rast të mospagimit, si dhe masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit, sipas dispozitave të ligjit nr. 105/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë", të ndryshuar.

g) Furnizuesi do të sigurojë aksesin *online* të faturës së konsumit për çdo klient fundor, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe faturimit.

Neni 8
Të drejtat e klientit fundor

8.1 Klienti fundor ka të drejtë:

a) të furnizohet me gaz natyror, në përputhje me kushtet e vendosura në këtë kontratë;

b) të paraqesë ankesë pranë përfaqësive të furnizuesit dhe pranë ERE-s, nëse nuk furnizohet, sipas kushteve të vendosura në kontratë;

c) të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;

d) të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit, në përputhje me nenin 6 të kësaj kontrate;

e) të drejtën për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi ka ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të gazit natyror;

f) të marrë informacion të plotë, me shkrim, për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standardë, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të gazit natyror;

g) të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;

h) të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit;

i) të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, të cilat, kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi;

j) të informohet, pa kosto shtesë, për konsumin e tij dhe kostot respektive të gazit natyror, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur klienti;

k) Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

Neni 9
Detyrimet e klientit fundor

9.1 Klienti fundor ka këto detyrime ndaj furnizuesit:

a) të paguajë për gazin natyror, në përputhje me kushtet e kontratës;

b) t'i mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të gazit natyror, pasi është njoftuar me shkrim 48 orë më parë.

c) të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit.

d) klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, në përputhje me vendimet e ERE-s, e cila vendos për përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

Neni 10
Çmimi i gazit natyror

10.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi, që rregullon sektorin e gazit natyror, çmimi i gazit natyror përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur klientit në faturën e konsumit të gazit natyror.

10.2 Ndryshimet e çmimit të gazit natyror bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim i çmimit, i bërë me vendim të ERE-s, do të aplikohet automatikisht në kontratë.

10.3 Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 5 ditë kalendarike përpara aplikimit.

Neni 11
Leximi i matësit dhe faturimi i gazit natyror

11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të gazit natyror të klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit, si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t'i dërgojë klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të gazit natyror, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

Çdo faturë e gazit natyror duhet të përmbajë minimalisht:

- të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- të dhëna identifikuese të klientit;
- data e leximit;
- periudha e faturuar;
- leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- çmimi për njësi, sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- shuma në lekë, që i korrespondon periudhës së faturimit;

- shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- data limit e pagimit të faturës;
- kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë;
- penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- vlera e detajuar e debisë së klientit;
- informacione të nevojshme për kujdesin ndaj klientit (përfshirë *website*-in e kompanisë, numrat e telefonit, *email* për ankesat, për defektet si të drejtën për të paraqitur ankesë pranë ERE).

Neni 12
Faturimi i gazit natyror gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

12.1 Në rast se të dhënat e aparatit të matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese, nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

12.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 12.1 për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati do të jetë zero.

12.3 Në rast të konstatimit të pasaktësive në matje, palët do të rregullojnë efektet në zbatim të parashikimeve të Kodit të Matjes dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 13
Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të gazit natyror jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.

13.2 Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës mujore të gazit natyror me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në zyrat e furnizuesit, bankave, zyrave postare apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

13.3 Të gjitha pagesat, sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e gazit natyror, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit. Sipas marrëveshjes me klientin faturat mund të dërgohen:

- klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- në adresë të një personi të tretë, i cili është përcaktuar si pagues nga klienti, sipas pëlqimit të tij.

13.4 Në të gjitha rastet, klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave, sipas kushteve të kësaj kontrate. Në rast se klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mospagesat e faturave të gazit natyror.

13.5 Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të klientit dhe shuma përkatëse, të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të klientit.

Neni 14
Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 13, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë të barabartë me 0.1% të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Neni 15
Pasojat e mospagesës

15.1 Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës, brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas nenit 13.1, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të klientit.

15.2 Nëse klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror, sipas nenit 12, atëherë furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me gaz natyror, sipas pikës 6.1.2, duke njoftuar me shkrim klientin.

Neni 16
Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të gazit natyror

16.1 Klienti fundor ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit, që lidhet me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon *(Call Center)* ose në rrugë elektronike.

16.2 Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me "Rregulloren e trajtimit të ankesave", të hartuar nga furnizuesi dhe të miratuar nga ERE. Kjo rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e gazit natyror, apo në zyrat e kujdesit ndaj klientit dhe në faqet elektronike të furnizuesit apo të ERE-s.

16.3 Në rast se furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën klientit fundor brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e mësipërme apo, nëse klienti fundor nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë ERE-s, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ERE-s. Ankesa në ERE mund të paraqitet jo më vonë se 12 muaj pas marrjes dijeni nga klienti të përgjigjes së trajtimit të ankesës nga furnizuesi në adresës e përcaktuar në këtë kontratë.

16.4 Klienti fundor mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga furnizuesi, por jo më vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

16.5 Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit rezulton se konsumatori është mbifaturuar atëherë furnizuesi:

i. anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrektuar;

ii. në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën e klientit brenda 3 muajve pasardhës.

Në rast të moskompensimit brenda afatit të përcaktuar me sipër, furnizuesi duhet të kompensojë klientin, me një penalitet 0.1% në ditë, për çdo ditë vonese, mbi vlerën e diferencës për t'u korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

16.6 Për faturat e kontestuara nga klienti, që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të tij (të krahasueshme ose më shumë se dyfishi i faturimit mesatar mujor të së njëjtës periudhë), furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përshpejtuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

16.7 Për faturat e ankimuara nga klienti nuk do të ndërpritet furnizimi me gaz natyror deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës për këtë faturë nga furnizuesi.

Neni 17
Instalimi dhe pronësia

17.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon te klienti fundor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së gazit natyror dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me "Rregulloren për lidhjet e reja". Matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar prej saj.

17.2 Klasa e saktësisë së matësve të gazit natyror përcaktohet në Kodin e Matjes, miratuar nga ERE.

17.3 Në veprimtarinë e matjes së gazit natyror mund të implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë.

17.4 Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

17.5 Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik, që lidhen me kryerjen e instalimeve të gazit natyror brenda objektit apo banesës së tij.

17.6 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të gazit natyror të vendosur brenda kufijve të pronës së tij.

Neni 18
Kontrolli i sistemit matës

18.1 Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

18.2 Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit ose me kërkesë të klientit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo subjektit të autorizuar. Periodiciteti i

verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

18.3 Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të klientit fundor, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e gazit natyror.

18.4 Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuesit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

18.5 Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga klienti, me qëllim të manipulimit apo të mosregjistrimit të saktë të gazit së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

18.6 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.

18.7 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga klienti nga ana e operatorit të rrjetit, merren masa për zëvendësimin e sistemit të matjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Furnizimi dhe karakteristikat e gazit natyror

19.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të gazit natyror. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e gazit natyror në rastet e mëposhtme:

a) për shkaqe të forcës madhore – ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit;

b) ndërprerje për shkak të urdhrave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

c) për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;

d) ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit;

e) ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata), për shkak të defekteve dhe të dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes.

19.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet parashikuara në germat "a", "b", "c", të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në germat "d" dhe "e" të pikës 19.1, furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në "Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror".

19.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe të procedurave të përcaktuara në "Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror", furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuara në rregulloren e mësipërme.

19.4 Në asnjë rast, përfitimi i kompensimit nga ana e klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 16.5, nuk e përjashton të drejtën e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

19.5 Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë së tensionit, sipas "Kodit të Shpërndarjes së Gazit natyror" dhe parametrat e vendosur në "Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror".

19.6 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen klientit, për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara "Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të Gazit Natyror" dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij.

19.7 Përcaktimi i dëmit efektiv të shkaktuar klientit, në rastet e pikës 19.6, bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

Neni 20
Detyrime të përbashkëta

20.1 Pasi të dyja palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në prezencë të klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elemente të tjera të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

- vulën e matësit: _____;
- numrin e serisë së matësit: _____;
- leximin aktual të tregimit të matësit: _____;
- si dhe një skemë të thjeshtë të furnizimit me gaz natyror përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

20.2 Çdo ndryshim i mëvonshëm i elementeve të përcaktuara në nenet 18 dhe 19 do të reflektohen në kontratë.

Neni 21
Ndryshimet e kontratës

21.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERE-s, sipas së njëjtës procedurë të miratimit të tyre.

22.2 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERE dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë klientët fundorë, që kanë të lidhur një kontratë furnizimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

22.3 Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e klientit fundor, ai mund të heqë dorë nga kontrata pa asnjë penalitet, pasi ka ekzekutuar më parë të gjitha detyrimet.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, dhe me pas gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 23
Legjislacioni i zbatueshëm

Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo kontratë do të zbatohen akte të tjera rregullatore, që lidhen me furnizimin si dhe dispozitat e Kodit Civil.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 167, datë 22.10.2020

MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "KOKA & ERGI ENERGJI STAVEC" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/3 prot., datë 19.10.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shtyrjen me 30 dite pune të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, të shoqërisë "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 143, datë 28.8.2020, ka filluar procedura për licencimin e shoqërisë "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/26, datë 28.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për

procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k.

- U konstatua se njoftimi drejtuar shoqërisë "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të mbetur, nuk ishte dërguar në afat.

- Ndodhur në kushtet kur shoqëria nuk ka marrë në kohë njoftimin e ERE-s, u vijua me dërgimin në rrugë zyrtare elektronike, në datën 15.10.2020, të këtij njoftimi.

- Me qëllim dhënien e kohës së arsyeshme për aplikuesin, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, lind nevoja e zgjatjes së afatit procedural për shqyrtimin e këtij aplikimi.

- Bazuar në nenin 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Koka & Ergi Energji Stavec" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në datë 9.11.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 109, datë 18.9.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MIRDITË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 18.9.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mirditë sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Mirditë (UK Mirditë), me shkresën nr. 84 prot., datë 20.2.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Mirditë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Mirditë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 20 511 banorë në Bashkinë Mirditë, përveç njësive administrative Kaçinar dhe Selitë;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Mark Leka, zotëron diplomë në Inxhinieri Metalurgji marrë në maj të vitit 1983 dhe ka 36 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mirditë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale; aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës; përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca; si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Mirditë, rekomandon se:

- shoqëria UK Mirditë duhet të përfshijë në zonën e shërbimit edhe njësitë administrative Kaçinar dhe Selitë, në zbatim të VKM-së nr. 63;

- shoqëria UK Mirditë duhet të aplikojë menjëherë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me një strukturë të re tarifore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mirditë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a., me NUIS: J69303012L, në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor - z. Mark Leka;

b) Drejtues teknik - z. Mark Leka.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a është: Bashkia Mirditë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 119, datë 20.10.2020

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME PEQIN SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12. 2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e

metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.10.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Peqin sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Peqin, (UK Peqin), me shkresën nr. 44 prot., datë 15.7.2019, me lëndë: "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura", ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Peqin në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40; me vendimin nr. 90, datë 28.7.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Peqin, për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

2. Ujësjellës-Kanalizime Peqin, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së me shkresën nr. 44 prot., datë 15.7.2019, "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura" propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tri kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria, sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara
	Zona ekzistuese	Zona e shtuar*	Zona e shërbimit
	Peqin, Shezë	Gjocaj, Karinë, Pajovë Përparim	Peqin, Shezë, Karinë Gjocaj, Pajovë, Përparim
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	30	Pa tarife të miratuar nga ERRU-ja	48
2. Klientë publikë	90		120
3. Klientë privatë	100		120
B. Tarifë volumetrike për KUN	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	Pa tarifë të miratuar nga ERRU-ja	Nuk ofrohet shërbimi KUZ	12
2. Klientë publikë			16
3. Klientë privatë			16
C. Tarifë fikse shërbimi	**lek/muaj/lidhje**	**lek/muaj/lidhje**	**lek/muaj/lidhje**
1. Klientë familjarë	50**	Pa tarife të miratuar nga ERRU-ja	100
2. Klientë publikë	50**		200
3. Klientë privatë	50**		200

* Edhe për zonën e shtuar shoqëria aplikon të njëjtin nivelin tarifor volumetrik që aplikohet për zonën ekzistuese të miratuar nga ERRU-ja.

** Nuk aplikon tarifën fikse 50 lek/muaj/lidhje të miratuar nga ERRU-ja, por aplikon 100 lek/muaj/lidhje me pretendimin se drejtuesit e kanë gjetur në zbatim të një tarifë të tillë.

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2019, për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU-ja për gjithë zonën e shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara, shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2019 dhe objektivat për vitin 2020 dhe vitin 2021, jepen në tabelën e mëposhtme:

Treguesit kryesorë të performancës, sipas shoqërisë, për vitet 2019–2020–2021

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1. Uji pa të ardhura	%	67.5	65	63
2. Mbulimi me ujë	%	47.6	47.9	51.1
3. Mbulimi me KUN	%	18.5	18.7	18.8
4. Niveli i matjes	%	97	97	100
5. Norma e arkëtimit korrente	%	87	88	90
6. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	22	23	24
7. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	22.8	22.7	15.4
8. Mbulimi i kostove O&M	%	47.3	48.5	78
9. Mbulimi i kostove totale	%	45	46	74

4. Shoqëria, në relacionin e saj, e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave, sipas argumenteve të mëposhtme:

a) Për arsye të riorganizimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

b) Aplikon për nivel të ri tarifor pas një periudhe të gjatë 10-vjeçare.

c) Aplikon për nivel tarifor të unifikuar për të gjithë zonën e shërbimit, për dy shërbimet FU dhe KUZ, për të gjithë zonën e shërbimit.

d) Aplikon për herë të parë për tarifat e shërbimit të KUZ.

e) Të ardhurat aktuale nga tarifat nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

f) Nevoja për përballimin e kostove të shtuara, si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

Treguesit e performancës në përgjithësi kanë tendencë pozitive nga viti në vit. Mbulimi me shërbimin e FU dhe KUN, të cilët janë në nivele të ulëta, e bën të domosdoshme ndërhyrjen me investime me qëllimin e shtrirjes së këtyre shërbimeve në të gjithë zonën e juridiksionit.

UK Peqin nuk arrin të mbulojë as 50% të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes dhe me tarifat e reja synon të përmirësojë këtë tregues për të pasur një situatë financiare më të favorshme.

5. Gjatë procesit të analizës teknike e ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuara në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Peqin, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike e financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Peqin të kritereve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, nëpërmjet vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove të Operimit & Mirëmbajtjes;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës, të përcaktuara.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë të miratuar me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve"; për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Peqin, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas aktit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	**lek/m³**
Konsumatorë familjarë	48
Konsumatorë publik	120
Konsumatorë privat	120
Tarifë volumetrike për KUN*	**lek/m³**
Konsumatorë familjarë	12
Konsumatorë publik	16
Konsumatorë privat	16
Tarifë fikse	**lek/muaj/lidhje**
Konsumatorë familjarë	100
Konsumatorë publik	200
Konsumatorë privat	200

*Tarifat e KUN-së do të zbatohen vetëm në ato pjesë të zonës së shërbimit ku ofrohet ky shërbim.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2021, për UK Peqin, do të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2021, të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	78
Uji pa të ardhura	%	60
Niveli i matjes	%	100
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	24
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	15.4
Mbulimi me ujë	%	51.1
Mbulimi me KUN	%	18.8
Norma e arkëtimit korrente	%	90

3. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit kryesorë të performancës dhe

REKOMANDON:

a) Shoqëria duhet të përditësojë planin e biznesit (pesëvjeçar) duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, me objektiva dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

b) Shoqëria UK Peqin, për të përballuar kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes duhet të aplikojë për ndryshim të nivelit tarifor, që të aplikohen jo më vonë se në vitin 2023, që edhe si rezultat i përmirësimit të treguesve të performancës të arrijë të mbulojë në nivelin 100% kostot O&M.

c) Shoqëria duhet të kontabilizojë kosto të ndara për secilin shërbim që ofron.

d) Bashkia Peqin dhe Këshilli Administrativ i shoqërisë duhet të angazhohet maksimalisht për sigurimin e fondeve nga qeveria qendrore, nëpërmjet AKUM-it, për investime, në mënyrë që të mund të përmirësohet cilësia e shërbimeve për zonën rurale, si dhe ofrimin e tyre për pjesën e popullsisë akoma të pambuluar në zonën e shërbimit.

e) Të hartojë planet e veprimit dhe të ndërmarrë aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme kryesisht në rrjetin e shpërndarjes, sidomos në zonën e shtuar rurale. Gjithashtu, shoqëria duhet të monitorojë saktësisht për të rivlerësuar volumin e ujit të autorizuar të pafaturuar (i cili ju falet sistemit të zjarrfikëseve dhe harxhohet për pastrimin e depove dhe rrugëve), i cili është në nivelin 12.5%.

f) Shoqëria duhet të hartojë një bilanc uji sa më real, që do të jetë rezultat i një analize të thelluar në terren, për të gjetur shkaqet e vërteta të rrjedhjeve, si faktor i rëndësishëm për uljen e humbjeve teknike dhe administrative që shkaktohen nga linjat e tubacioneve të shpërndarjes së sistemeve, sidomos për zonat rurale të shtuara.

g) Të bëjë përpjekje për të realizuar instalimin e matësve të mëdhenj në pikat e prodhimit të ujit dhe në pikat kyçe të rrjeteve shpërndarëse.

h) Shoqëria duhet të përfundojë inventarizimin e plotë të aseteve dhe sipas standardeve, rivlerësimin e tyre, që të merret parasysh në planin 5-vjeçar të biznesit, për vlerësimin e saktë të amortizimit të aseteve, planifikimit dhe sigurimit të fondeve rezervë të kapitalit për zëvendësimin. Gjendja paraqitet urgjente për asetet e zonës rurale.

i) Duke qenë se zona e shërbimit paraqitet e zhbalancuar në drejtim të sasisë së ujit të prodhuar, ku për Qytetin e Peqinit prodhohet një sasi mjaft e madhe uji për furnizimin e popullsisë, ndërsa për zonën rurale kjo është në limitet e plotësimit të normave të kërkesës për ujë për banor, të bëhet një vlerësim më i thelluar i gjendjes së kërkesës për ujë dhe humbjeve për çdo sistem të veçantë furnizimi me ujë në zonën e shërbimit edhe në funksion të cilësisë së shërbimit (orëve të furnizimit me ujë) që operon secili sistem.

j) Të respektohet kushti teknik për disponibilitetin e pompave rezervë në stacionet e pompimit, sidomos në Karinë, Përparim dhe Trash, si dhe në stacionet e pompimit me pompa zhytëse, për të cilat shoqëria duhet të disponojë në magazinë nga një të tillë për çdo tip të pompës.

k) Të zgjidhet ligjërisht me institucionet përkatëse, nga shoqëria e Drejta e Servitutit, për të pasur akses në të gjithë asetet e saj që kalojnë në prona private në mënyrë që të ketë nën kontroll situatën për gjendjen e tyre, si edhe që të mund të realizojë një analizë të thelluar të gjendjes në terren, për të gjetur shkaqet e vërteta të rrjedhjeve dhe lidhjeve të paligjshme në tubacionet që kalojnë në këto prona.

l) Bazuar në studimin e eficiencës së energjisë që disponon shoqëria, hartuar me ndihmën e projektit të financuar nga GIZ, të rriten përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve (aty ku është e mundshme) për uljen e kostove të energjisë elektrike në të ardhmen, për sistemet e furnizimit me ujë të zonës së shtuar rurale.

m) Shoqëria duhet të gjejë mundësinë të hartojë projektzbatimet për zgjerimin e rrjeteve, apo të ndërtimit të sistemeve të reja të furnizimit me ujë dhe KUN, për të bërë të mundur aplikimin pranë AKUM-it, për të siguruar financimin e këtyre projekteve, për të rritur numrin e konsumatorëve familjarë dhe bizneseve që përfitojnë nga këto shërbime.

n) Shoqëria, në bashkëpunim me Bashkinë Peqin, duhet të rrisë interesimin për të marrë pjesë në një zgjidhje rajonale të trajtimit të ujërave të ndotura në impiante trajtimi të tyre. Shoqëria gjithashtu duhet të rrisë kontrollin dhe monitorimin për gropat septike në zonat rurale, që

duhet të jenë në përputhje me standardet teknike për ndërtimin dhe operimin e tyre.

4. Referuar metodologjisë së vendosjes së tarifave, pika 2, neni 3, shoqëria UK Peqin bën pjesë tek operatorët që mbulojnë deri në 50% të kostos totale. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Peqin sh.a. do të jetë 0.5% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti, përkatësisht 272 000 lekë/vit.

5. Lidhjen e kontratës me UK Peqin brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

6. Vendimi nr. 43, datë 30.7.2010, "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Peqin sh.a." shfuqizohet.

7. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.12.2020 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 120, datë 20.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 67, DATË 19.12.2019, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.10.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier (UK Fier) me shkresat nr. 262 prot., datë 30.4.2020, me lëndë "Plotësim dokumentacioni"; nr. 500, datë 9.7.2020, me lëndë "Plotësim dokumentacioni", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për zgjerimin e zonës së shërbimit, dy aktmiratime higjieno-sanitare, në të cilat përfshihen tri njësitë e tjera administrative Topojë, Dermenas dhe Libofsh, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Fier, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Fier me vendimin nr. 5, datë 3.2.2017; nr. 67 datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a." me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

Bashkia Fier: Njësia Administrative Fier
Qendër
Portëz
Frakull
Cakran
Mbrostar
Levan

4. KKRR-ja, në vendimin nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a." i rekomandoi shoqërisë UK Fier që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit, me aktmiratim higjieno-sanitar.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fier është e bazuar ligjërisht dhe plotëson

kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit të KKRR-së nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.", bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a është Bashkia Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 122, datë 20.10.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", (VKM-së nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.10.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a., për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kukës (UK Kukës) me shkresën nr. 397 prot., datë 1.9.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Kukës, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) UK Kukës ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 63;

b) Shoqëria UK Kukës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 35 845 banorë në Bashkinë Kukës;

c) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Kukës sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kukës, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale; aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës; përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca; si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Kukës rekomandon:

- Shoqëria UK Kukës duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura për të gjithë zonën e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kukës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a., me NUIS: J67902228S, në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Asllan Hoxha;

b) Drejtuese teknike –Hazbije Onuzi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a është Bashkia Kukës.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

NJOFTIM
Nr. 13070, datë 4.11.2020

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash, e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e programit të ristrukturimit dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin ballkanik, fuqizimi i kapacitetit të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit, nënshkruar më 17.7.2019 dhe 13.8.2019, ka hyrë në fuqi më 16 shtator 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË
Nr. 4759/2, datë 4.11.2020
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

